

numër 1
shtator 2015

toka

IME

REVISTË PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL



NË POLIN E JUGUT ME TRAKTOR

20
euro për
kilogram



Lakër kineze



Arra të shartuara



Mollë shtyllore



Api-lift



**BIMË MJEKUESE:
MËLLAGA
E BARDHË**

3

**MBROJTJE:
MBROJTA E
LAKRËS**



4



**KOPSHTARI:
MARRËDHËNIE TË
DOBISHME DHE JO TË
DOBISHME MIDIS BIMËVE**

6

**VRESHTARI:
THARTËSIRA
NË VERË**



11



**BLEGTORI:
DELJA
SHAROLE**

23



**FEDERATA E FERMERËVE NË
REPUBLIKËN E MAQEDONISË**

FEDERATA E FERMERËVE NË R.M.

Adresa: rr. Hristo Smirnenski nr.15 1000 Shkup
Tel.:389 02 3099 044, Faks:389 02 3099 044
e-mail: ffrm@ffrm.org.mk
uebfaqe:www.ffrm.org.mk



AGROPUKA

Adresa: Lagjja e Re, Pukë
Tel.+355 212 2 2412. Mob.:+355 68 23 88 169/
+35569 57 42 060/ +35567 20 70 490
e-mail: agropuka@gmail.com
uebfaqe: www.agro-puka.org



AGRINET ALBANIA

Adresa: Lagja 7 rr. "Ligor Rembeci"
Nr. 8, Korçë Albania
Tel: +355 82254655, Mob.: +355 684060530
Email: info@agrinet.al tpikuli@agrinet.al
uebfaqe: www.agrinet.al



INITIATIVE FOR KOSOVA COMMUNITY

Adresa: rr. Gjon Serreçi, p.n, Ferizaj, Kosovë
Tel: 038742190, Mob:+377 [0]44 368 356
Faks: 038742190
e-mail:main@ngoikc.org
uebfaqe:www.ngoikc.org

Revista për bujqësi dhe zhvillim rural "Toka ime" është revista e parë rajonale onlajn në gjuhën shqipe, që u dedikohet të gjitha palëve të interesuara në sektorin bujqësor dhe është e lirë dhe pa pagesë për të gjithë lexuesit. Çdo person fizik dhe juridik nuk ka të drejtë ta printojë dhe shesë revistën "Toka ime" për të realizuar fitim. Pronarë të kësaj reviste janë FFRM, AGRINET, AGROPUKA, IKC për Shqipëri-në, Maqedoninë dhe Kosovën. Ne jemi të hapur për bashkëpunime të reja dhe pronarë të rinj nga shtete të tjera me qëllim të vetëm zhvillim dhe bashkim të rajonit në suazat e sektorit bujqësor.



Toka ime, shtator 2015

Botues: FFRM Media

Adresa e selisë dhe redaksisë:
rr. Hristo Smirnenski, nr. 15,
1000 Shkup

Udhëheqës: Bllagojçe Najdovski

Tel/faks: 02 3099042

e-mail: mojazemja@gmail.com

Redaktori kryesor
dhe përgjegjës:
Biljana
Petrovska-Mitrevska
Botuar më:
shtator 2015

Fotolajm kopertina
Bllagojçe Najdovski

Përktheu: Jordana Shemko-Georgievska
Redaktimi profesional: prof. Gazmend Bakii
Gazetar: Monika Risteska

Bashkëpunëtorë profesionale
Dr. Vitor Malutaj, inxh. agr. dipl. Ivan Stojanov, inxh. agr. dipl. Jelica Beshliq, inxh. agr. dipl. Stojan Gligorov, inxh. agr. dipl. Bllagojçe Dimitriev, inxh. agr. dipl. Vanço Zahariev, inxh. agr. dipl. Llambe Kucinovski, inxh. agr. dipl. Ivica Velinov, inxh. agr. dipl. Rankica Bozhinovska, inxh. agr. dipl. Dimitar Arnaudov, Sasho Nikollovski, Sashko Stoshij, Ivan Mickovski, Mile Kostov, Nikolla Stanishev, Nenad Stepaniç, inxh. agr. dipl. Ivan Stojanov, inxh. agr. dipl. Kostadinka Vasilevska, Tomi Pikuli, Nikolin Karapanci, Sabah Djaloshi, Bekim Bajrami, Doruntina Kurteshi, Ekrem Bajrami
Dizajn: Brigada dizajn [brigada.mk]



Kushte për rritjen e MËLLAGËS SË BARDHË

Kjo bimë nuk mund të kultivohet në një vend për një periudhë më të gjatë kohore dhe prandaj bëhen pauza 4-5 vjeçare. Gjatë kësaj, duhet të kihet parasysh kultura e mëparshme pas vete të lërë një truall të pastër dhe të shkrifët.



Shkruan: Dipl. inzh. agr. Rankica Bozhinovska

Mëllaga e bardhë është bimë e cila rritet në rajone me klimë kontinentale dhe të ndryshueshme kontinentale. Sidomos rritet me sukses në rajone me klimë të butë dhe lagështi mesatare, por nuk është e ndjeshme edhe ndaj temperaturave të ulëta të dimrit. Pa u dëmtuar, mëllaga e bardhë mund të durojë temperaturë edhe deri në +30°C. Kjo bimë nuk jep prodhim të mirë në rajone me lartësi të madhe mbi nivelin e detit. Baza e suksesit gjatë kultivimit të mëllagës së bardhë është përzgjedhja e mirë e tokës. Prodhimin më të madh e jep në toka të freskëta aluviale, lumishte, të zeza dhe në të gjitha llojet e tokave me strukturë fizike të përshtatshme. Mëllaga e bardhë nuk duhet të kultivohet në tokë ngjitëse që nuk e lëshon ujin dhe llojet e tjera të tokave të rënda. Në toka të begatshme dhe pjellore jep të ardhura rekord, megjithatë më shpesh këto toka përdoren për kultivim të kulturave të kopshtarisë. Për kultivimin e mëllagës së bardhë zgjidhen parcela të cilat përmythen periodikisht sepse mund të qëndrojnë 20-30 ditë nën ujë pa u dëmtuar. Me t'u tërhequr uji, kjo bimë vazhdon të zhvillohet normalisht.

Kultivimi

Në një vend mëllaga e bardhë mbetet një deri në dy vjet. Ajo nuk duron të kultivohet në të njëjtin vend për një periudhë më të gjatë kohore. Mënyra e tillë e kultivimit mund të çojë në shfaqjen e shumë sëmundjeve dhe dëmtuesve të bimëve.

Renditja e mëllagës së bardhë duhet të jetë e tillë që në të njëjtën tokë kultura të kthehet pas 4-5 vjetësh. Gjatë kësaj duhet pasur parasysh kultura e mëparshme të lërë një tokë të pastër dhe të shkrifët.

Përpunimit të tokës për mëllagën e bardhë duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë. Duke marrë parasysh rrënjën e saj të degëzuar, qëllimi thelbësor i përpunimit të tokës është të krijojë një shtresë të thellë të lërimet e cila do të mundësojë zhvillimin e saj pa pengesë. Gjatë përpunimit të tokës shkatërrohen edhe barërat e këqija, murrizat.

Trualli për mëllagën e bardhë duhet të lërohet në vjeshtën e hershme. Thellësia varet nga lloji i truallit, por megjithatë nuk duhet të jetë më e vogël se 30-40 cm. Nëse mëllaga e bardhë mbillet në vjeshtë, trualli kultivohet, kurse nëse bima mbillet në pranverë, parcela e lëruar lihet të dimërojë me brazda të hapura, kurse në pranverën e hershme përpunohet.

Ekzistojnë disa mënyra për shumimin e mëllagës së bardhë. Prej tyre më shpesh zbatohen këto dy mënyra:

1. Mbjellja e farave në parcelat prodhuese;
2. Prodhimi i fidanëve në leha të ftohta, kurse pastaj mbillen fidanët në vend të përhershëm.

Shumimi me mbjellje të drejtpërdrejtë është më i mirë dhe më ekonomik. Mbjellja kryhet në vjeshtën e vonshme, ose në fund të shkurtit. Pa dallim se a bëhet fjalë për mbjellje në vjeshtë apo në pranverë, parcela duhet të jetë e përgatitur mirë, kurse trualli duhet të jetë i imët. Gjatë mbjelljes lihet largësi prej 50 cm midis radhëve. Mbillet cekët, 1-2 cm, sepse fara është e imët. Për mbjellje të një hektari toke nevojiten 6-8 kg farë. Gjatë shumimit të mëllagës së bardhë sipas mënyrës së dytë, me ndihmë të leheve, mbjellja kryhet në radhë në largësi prej 15-20 cm. Për mbjellje në lehtë prej 1m2 nevojitet 8-10 kg farë.

Nga mëllaga e bardhë përdoren rrënja, gjethja dhe lulja. Rrënja hiqet gjatë vitit të parë ose të dytë të kultivimit, kurse gjethet mbledhen 2-3 herë në vit. Lulja mbledhet gjatë vitit të parë dhe të dytë të kultivimit, kurse pastaj thahet në diell.

Të ardhurat

Të ardhurat e mëllagës së bardhë varen nga masat agroteknike të ndërmarra. Nga një hektar mund të merren 1.200 deri në 2.000 kg rrënjë të thata, 500-600 kg gjethë dhe rreth 150 kg lule të mëllagës së bardhë. ●




Mbillet në verë, mblidhet në dimër

Një prej perimeve më të shëndetshme të familjes së lakrave, me shumë vlera ushqyese, e cila nuk është e vështirë për t'u kultivuar dhe mund të kultivohet gjatë gjithë vitit në përputhje me rekomandimet

Shkruan: Stojan Gligorov

Emri anglez i kësaj kulture është Savoy cabbage, kurse emri latinisht është Brassica oleracea var. sabauda. Lakra e gjelbër është bimë dyvjeçare e familjes së lakrave Brassicaceae. Kjo bimë është më e qëndrueshme se lakra e zakonshme, sepse i duron më mirë temperaturat e larta dhe thatësinë, por edhe temperaturat e ulëta dhe akullin. Prandaj është ideale për kultivim në kushtet tona. Gjethet janë me flluska dhe nuk janë të ngjitura fort njëra me tjetrën, prandaj koka e lakrës së gjelbër nuk është kaq e fortë si te lakra e zakonshme. Ngjyra e gjetheve lëviz nga e gjelbër e errët, siç janë në shumicën e rasteve gjethet e jashtme, deri në të gjelbër në të verdhë, siç janë ato në brendësi, gjethet më të reja. Ekzistojnë disa lloje të lakrës së gjelbër të cilat për shkak të pamjes së tyre interesante shërbejnë si bimë dekorative. Kjo perime përmban shumë vitaminë C, kalium, është e pasur me proteina, kurse ka një vlerë shumë të ulët kalorie, që e dëshmon vlerën e saj të jashtëzakonshme biologjike ushqyese. Vetëm 70 gram lakër të gjelbër përmban rreth 33 kalori, 2,21 g proteina, 6,7 g karbohidrate, 1 g fibra dhe rreth 0,47 lipide.



Kushte në të cilat rritet

TEMPERATURA

Në fazën e rozetës dhe kokrrës, lakra e gjelbër është më rezistente ndaj temperaturave të ulëta. Fara e mbjellë në lagështinë e nevojshme të tokës fillon të mugullojë në temperaturë 1-5°C. Gjatë temperaturës optimale prej 20°C, fara e lakrës së gjelbër mugëllon, kurse bima mbin për 5-6 ditë. Për rritjen vegetative të bimës është optimale temperatura 15-20°C, kurse rritja e bimës përfundon në temperaturë më të lartë se 250C. Kur kushtet bëhen të përshtatshme, zhvillimi vazhdon. Për formimin e kokës temperatura optimale është 15-18°C.

UJI

Filizat e rinj duhet të ujitën rregullisht (çdo mbrëmje, nëse periudha është e thatë). Me kalimin e kohës, kur të bëhen më të fuqishëm dhe më rezistentë, ujitja zvogëlohet shkallë-shkallë.

TOKA

Lakra e bardhë ka nevoja mjaft të larta për tokë cilësore dhe me humus. Lakra e gjelbër mund të rritet në çdo lloj toke, me kusht që të jetë e thellë, e strukturuar dhe të ketë kapacitet të mirë për ujë dhe ajër, me pH prej 6 deri në 6,4 përkatësisht tokë me aciditet të lehtë. Për prodhimin dhe mbjelljen pranverore, më e përshtatshme është toka e cila ka përbërje më të lehtë mekanike dhe që ngrohet shpejt. Me kushte të mira të tokës dhe klimës dhe me përzgjedhje të llojeve përkatëse hibride, mund të prodhohet lakër e gjelbër e hershme edhe në hapësira të hapura.



Masat agroteknike

RENDI I BIMËS

Lakra e gjelbër bëhet mirë nëse mbillet dhe prodhohet pas vjeljes së kulturave bishtajore siç janë bizelja, fasulja, thjerrëza etj., pastaj kastraveci, patatja, drithërat, por edhe në livadhet natyrore dhe artificiale. Nuk është e përshtatshme për kultivim në monokulturë, domethënë

se në të njëjtën sipërfaqe mund të mbillet pas 3 ose 4 vjetësh. Në këtë mënyrë anashkalohet theksueshëm shfaqja e sëmundjeve të rrezikshme dhe e dëmtuesve, por në atë mënyrë rritet theksueshëm cilësia dhe prodhimi. Lakra e gjelbër është shumë e mirë si parakulturë për shumë kul-

tura perimesh, sepse pas mbledhjes të një maste të theksuar organike dhe truall me pak barëra të këqija, përkatësisht me pak fara të barërave të këqija. Në prodhimin intensiv në hapësirë të mbrojtur, lakra e gjelbër ka një renditje më të ngushtë sesa kulturat me të cilat zëvendësohet.

PËRPUNIMI I TOKËS

Koha dhe mënyra e përpunimit të tokës varen nga koha e kultivimit të lakrës së gjelbër. Baza e përpunimit të tokës kryhet në periudhën vjeshtë-dimër, menjëherë pas plehërimit bazë. Lërimi është me thellësi prej 30 cm. Brazda e lëruar lihet e pa prekur

deri në pranverë, kur toka përgatitet për mbjelljen e fidanëve. Për afatet më të vonshme të mbjelljes, përpunimi kryhet në të ashtuquajturën një fazë, që lidhet me plehërimin, lërimin, kultivimin dhe nivelimin e sipërfaqes së tokës, që të mbushen gropa

e sipërfaqes, në të cilat për një kohë më të gjatë do të qëndrojë uji i shiut. Qëllimi i përgatitjes së truallit për mbjellje të fidanit të lakrës së gjelbër është rrafshimi i truallit dhe mbledhja e strukturës së mirë në shtresë prej 8-10 cm.

PLEHËRIMI

Gjatë përgatitjes së tokës, është e nevojshme të hidhet sa më tepër pleh i mirë humus prej stalle. Gjatë plehërimit bazë, gjithashtu nevojitet të shtohet edhe pleh NPK 12:11:18 + 3MgO ose një kombinim i ngjashëm

i plehut kristalon. Ushqimi kryhet dy herë në javë, kurse nëse kultivimi është klasik në arë, atëherë është e nevojshme të kryhen tri ushqime gjatë kultivimit. Ushqimi ndalon kur madhësia e kokrrës së lakrës do t'i

mbulojë radhët. Edhe në njërin rast edhe në tjetrin duhet të kihet para-sysh të ndalohet ushqimi dhjetë ditë para mbledhjes.

MBJELLJA E FARËS DHE FILIZAVE

Për prodhimin e hershëm pran-veror, fara duhet të mbillet në leha të ngrohta, në sera gjatë nëntorit dhe dhjetorit, kurse pas 30 deri 35

ditësh mbillen filizat. Lakra e gjelbër mund të mbillet dhe kultivohet gjatë gjithë vitit, që varet nga lloji, por edhe nga gjatësia e vegjetimit. Mbillet në

largësi për lloje të hershme prej 40 x 40 cm ose 50 x 50 cm, kurse për llojet mëdha në largësi prej 60 x 40 cm ose 65 x 50 cm.

KUJDESI PËR FIDANISHTEN

Derisa bima në fidanishte është e vogël, nevojitet ujitje e rregullt dhe heqje e plehrave të këqija. Kur bimët

do të rriten, kanë masë të bujshme të gjelbër e cila deri në një masë e zvogëlon rritjen e barërave të këqija,

por nëse kjo nuk është kështu dhe shfaqen dëm prej dëmtuesve, mbjellja mund të trajtohet me mjete mbrojtës.

MBLEDHJA

Lakra e gjelbër mblidhet me dorë, me prerjen e kokrrave dhe kjo zakonisht kur temperaturat do të bien nën zero. Sa më gjatë të jetë e pasqyruar lakra e gjelbër në të ftohtë aq më e

ëmbël është. Por, kjo funksionon vetëm nën dritën e diellit. E njëjta nuk vlen për ruajtje në frigorifer. Të ardhurat e lakrës së gjelbër varen a është lakra e llojit të hershëm apo të

vonshëm. Për llojet e hershme mund priten të ardhura prej 20 deri në 25 t/ha, kurse për të vonshmet nga 40 deri në 60 t/ha.



Marrëdhënie të dobishme dhe jo të dobishme midis bimëve



Shumë bimë rriten më me sukses nëse kanë bimë fqinje të cilat u korrespondojnë dhe e mbështetin rritjen e tyre. Në të kundërt, shkaku për prodhimin e dobët mund të jetë pikërisht fqinji i keq të cilin kultura konkrete nuk e duron.

Shkruan: Dipl. inzh. agr. Vanço Zahariev

Gjatë çdo vështirimi të natyrës së paprekur nga dora e njeriut, secili mund të vërë re se ajo është bashkësi jetësore e përbërë nga një numër i shumëllojshëm i botës bimore dhe shtazore që jeton dhe mbijeton falë shumëllojshmërisë dhe raporteve të ndërmjetme të dobishme që janë bazë e ekuilibrit, mbijetesës dhe zhvillimit.

Në momentin kur njerëzimi vendosi të kultivojë bimë të cilat janë të

dobishme vetëm për të por edhe nuk i kanjohur këto marrëdhënie dhe ka ecur në drejtim të kultivimit të të mbjellave të një lloji prandaj me kalimin e kohës janë grumbulluar probleme të reja të cilat i zgjidh me mjete dhe mënyra që kushtojnë shumë, kurse më e rëndësishmja është se vazhdon krijimi edhe i më tepër problemeve të komplikuara në fitimin e prodhimit bimor.

Megjithatë falë përvojave dhe shkencës që sot ofron njohuri të tërë-

sishme dhe bashkëkohore për bashkësitë natyrore të botës bimore dhe shtazore dhe gjithnjë dhe më tepër synohet ndotja sa më e ulët e prodhimeve bimore dhe zhvillimi i tyre i qëndrueshëm dalëngadalë po fillon zbatimi i këtyre njohurive, sidomos në kopshtari në kultivimin e kulturave të cilat mbështetin njëra-tjetrën në zhvillim dhe qëndrueshmëri, kurse anashkalohet kultivimi i atyre kulturave të cilat e dëmtojnë njëra-tjetrën.



Prej zbatimeve të shumta në praktikë mund t'i japim këto:

1. HUDHRA – fqinj të mirë janë: luleshtrydhja, kastravec, karota, domatja dhe frutat, kurse të padëshirueshëm janë: fasulja, bizelja dhe lakra;

2. BORZILOKU – fqinj të mirë: fasulja dhe sallatat;

3. MASHURKA – fqinj të mirë: rrepka, kastravec, marulja, panxhari, selinoja, domatja, spinaqi, kungulleshka, rrepa, kurse të padëshirueshëm janë: qepa, hudhra, preshi;

4. SELINOJA – fqinj të mirë: fasulja, kastravec, lakra, preshi, domatja dhe spinaqi, kurse e padëshirueshme është patatja;

5. PANXHARI – fqinj të mirë: qepa, marulja, fasulja, kurse i padëshirueshëm është spinaqi;

6. QEPA – fqinj të mirë: kastravec, domatja, karota, luleshtrydhja, panxhari, kamomili dhe kopra, kurse të padëshirueshëm janë: fasulja, lakra, bizelja dhe preshi;

7. BIZELJA – fqinj të mirë: kopra, karota, lakra, kohlabri (келебаб), sallatat, rrepka dhe rrepa, kurse të padëshirueshme janë: patatja, preshi, hudhra, qepa, fasulja dhe domatja

8. KADIFEJA (Tagetes sp.) – fqinj të mirë: lakra, domatja dhe çervil (Anthriscus cerefolium) (перевиз);

9. KOHLABRI – fqinj të mirë: fasulja, bizelja, patatja, preshi, çervil, marulja, rrepa, spinaqi, domatja dhe misri, kurse të padëshirueshme nuk ka;

10. KASTRAVECI – fqinj të mirë: fasulja, kopra, qepa, hudhra, lakra, marulja, çervil, kurse e padëshirueshme është rrepa;

11. PATATJA – fqinj të mirë: fasulja, kopra, qepa, hudhra, lakra, sallatat verore, çervil, domatja, marulja dhe kungulleshka, kurse të padëshirueshëm janë: bizelja, lakra, çervil, domatja, marulja dhe kunguj;

12. KOPRA – fqinj të mirë janë: frutat, rrepa dhe fasulja;

13. DOMATJA – fqinj të mirë: fasulja, karota, qepa, lakra, kohlabri, sallatat, preshi, majdanozi, çervili, rrepka, sherbela, merudhia, rozmarina dhe kadifeja, kurse të padëshirueshëm janë: bizelja, lakra, sallatat dhe kunguj;

14. FASULJA – fqinj të mirë: kastravec, bosiloku, lakra, kohlabri, marulja, rrepka, çervil, domatja, rabarbara dhe lëpjeta, kurse të padëshirueshëm janë: qepa, hudhra dhe preshi;

15. MAJDANOZ – fqinj të mirë: rrepa e bardhë dhe e zezë, domatja dhe luleshtrydhja, kurse e padëshirueshme është marulja;

16. PRESHI – fqinj të mirë: luleshtrydhja, karota, lakra, kohlabri, marulja, çervil, domatja, kurse e padëshirueshme është qepa;

17. RRIKË – fqinj të mirë: patatja, afioni dhe pemët;

18. RREPA – fqinj të mirë: fasulja, bizelja, luleshtrydhja, karota, lakra, kohlabri, marulja, majdanozi, spinaqi, domatja, trumza, kopra dhe mashurka, kurse i padëshirueshëm është kastravec;

19. MARULJA – fqinj të mirë: fasulja, bizelja, luleshtrydhja, kastravec, lakra, kohlabri, preshi, domatja, qepa dhe borziloku, kurse i padëshirueshëm është majdanozi;

20. SPINAQI – fqinj të mirë: patatja, lakra, kohlabri, rrepa, fasulja, domatja, kurse i padëshirueshëm është panxhari;

21. KAROTA – fqinj të mirë: bizelja, kopra, qepa, rrepka, kumaku dhe sherbela, kurse të padëshirueshëm nuk ka;

22. LAKRA – fqinj të mirë: luleshtrydhja, kastravec, marulja, çervil, preshi, rrepa, spinaqi dhe domatja, kurse të padëshirueshme janë: qepa, hudhra, patatja, bizelja dhe fasulja;

23. KUNGULLESHKA DHE KUNGUJ – fqinj të mirë: qepa, mashurka e lartë, të padëshirueshme nuk ka. ●



Kultivimi

Lakra kineze bëhet gati për mbledhje 70 ditë pas mbjelljes, me peshë të një kokrre 1,5-2 kg dhe konsiderohet si një prej bimëve që rriten më shpejt nga familja e kulturave të lakrës

Shkruan: Dipl. inzh. agr. Dimitar Arnaudov

Lakra kineze tek ne kultivohet në sipërfaqe të vogla, por megjithatë shkenca e konsideron këtë bimë si me shumë perspektivë, më tepër për shkak të periudhës së shkurtër të vegjetimit dhe të prodhimtarisë relativisht të lartë.

I duron me lehtësi temperaturat e ulëta

Si rregull praktikohet kultivim ku mbledhja planifikohet para shfaqjes së ngricave të forta. Kokrrat e lakrës të cilat nuk janë pjekur i durojnë lehtë temperaturat e ulëta, madje deri në -10 gradë, kurse kokrrat e pjekura të

lakrës durojnë vetëm disa gradë nën pikën e ngrirjes. Edhe pse më shpesh praktikohet kultivim vjeshtor i lakrës kineze, me zhvillimin e hibrideve të reja të cilat nuk janë të ndjeshme ndaj gjatësisë së ditës mundësohet kultivim edhe gjatë periudhave të pranverës dhe verës.

Lakra kineze bëhet gati për mbledhje 70 ditë pas mbjelljes, me peshë të

një kokrre 1,5-2 kg dhe konsiderohet si një prej bimëve që rriten më shpejt nga familja e kulturave të lakrës. Për sipërfaqe prej 1 ha nevojiten 50.000 – 70.000 bimë, kurse largësia optimale për mbjellje është 40-50 x 30-40 cm. Të ardhurat optimale janë 25-30 ton.



lakrës kineze

Prodhim i fidanëve

Rekomandohet që mbjellja të kryhet në kontejnerë plastikë ose prej stiropori sepse lakra kineze ka rrënjë të brishta në fazat fillestare të rritjes dhe zhvillimit. Me këtë mënyrë të prodhimit të fidanëve prodhuesi ka mbikëqyrje më të madhe, mundësi për ujitje dhe mbrojtje të mirë të kulturës. Në fazën e mugullimit dhe mbirjes temperatura optimale duhet të jetë 18-22 gradë, kurse më vonë për rritje dhe zhvillim normal, lakrës kineze i nevojitet një temperaturë pak më e ulët e cila duhet të jetë 15-18 gradë.

Trualli

Në fazën e rritjes dhe zhvillimit intensiv lakra kineze është e ndjeshme ndaj mungesës së lagështisë në truall, sepse rritja e shpejtë e kokrrës së lakrës kërkon shumë ujë. Si edhe kulturat e tjera të familjes së lakrave, ashtu edhe lakra kineze më mirë rritet dhe zhvillohet në truaj me peshë mesatare, humus, të strukturuar me përqindje të lartë të PVK-së. Vlera optimale e pH-së së truallit është 6,5-7,5. Parakulturat më të mira të lakrës kineze, por në përgjithësi edhe të të gjitha kulturave të lakrës, janë drithërat, pastaj patatja, sallata dhe perimet me rrënjë.



Plehërimi i lakrës kineze

Për prodhim prej 500 kg/m³ nevojitet plehërim me azot (N) në sasi prej 2,4 kg/100m², R205 0,6 kg/100m²; K20 2,4 kg/100m²; MgO 0,4 kg/100m²; CaO 1,15 kg/100m²; Sasia e këtyre materieve ushqyese zvogëlohet për 30-50 nëse kryejmë ushqim të bimëve me sistemin pikë për pikë me plehra minerale të tretshme në ujë.



Mbrojtja e lakrës kineze

Lakra kineze është shumë e ndjeshme ndaj kërpudhës *Alternaria brassicae* e cila shkakton njollën e zezë. Infeksioni dallohet me njollat e errëta pothuajse rrethore në të cilat dallohen rrathë. Temperaturat e lartë të shoqëruara me lagështi relativisht të lartë të ajrit e stimulojnë zhvillimin e kësaj kërpudhe.

Problemi më i madh në prodhimin e lakrës kineze janë insektet e dëmshme, midis të cilave brumbulli i gjelbër (*Phyllotreta nemorum*) dhe vëmjet e dëmshme (mola e lakrës, krimbi i gjethes). Këta dëmtues zhvillohen më shpesh gjatë periudhave të ngrohja me diell dhe shpesh shfaqen dhe shkaktojnë dëme kur lakra kineze është në fillim të formimit të kokrrës. ●



Mbrojtja e lakrës

Shkruan: Dipl. inzh. agr. Bllagojçe Dimitriev

Lakra në këtë periudhë të vitit është shumë aktuale. Për prodhimin e një lakre të mirë dhe cilësore duhet t'u kushtohet vëmendje disa sëmundjeve dhe dëmtuesve. Megjithatë, para së gjithash, duhet të kihet kujdes edhe prej barërave të këqija duke përdorur herbicid efikas. Për shkatërrimin e barërave të këqija tek lakra para mbjelljes duhet të përdoret një prej këtyre dy herbicideve **STOMP AQUA** ose **STOMP 330 E**. Këto herbicide përdoren për shkatërrimin e barërave të këqija njëvjeçare gjethegjera por edhe të zakonshmet. **STOMP AQUA** karakterizohet nga efikasiteti i lartë ndaj florës së barërave të këqija dhe toleranca e lartë për kultivim të lakrës. Këto karakteristika i sigurojnë të jetë universal dhe të jetë në krye të listës së herbicideve. Barërat e këqija të cilat i shkatërron ky herbicid janë meli (*Echinochloa crus-galli*), labodi i egër (*Chenopodium album*), *Setaria* spp, bar thëllëze (*Amaranthus retroflexus*); meli unazor (*Diditaria* spp), *Sorghum halepense*, *Apera spica-venti*, yll (*Stellaria media*), bar pate (*Poligonum* spp) dhe shumë barëra të tjera fletëgjera dhe të zakonshme. **STOMP AQUA** është formulë e kapsulave mikro dhe makro të tretshme në ujë me materie aktive pendimentalinë 455 gr/l dhe përdoret në dozë prej 3l/ha, kurse **STOMP 330 E** përmban materie aktive pendimentalinë 330 gr/l dhe përdoret në dozë prej 5l/ha. Për shkatërrim të barërave të këqija fletëgjera dhe të zakonshme mund të përdoret edhe herbicidi **WING P** në dozë prej 4l/ha. Për luftimin e këtyre sëmundjeve mund të përdoren disa fungicide. **ORVEGO** është fungicid i ri sistematik inovativ për shkatërrimin e bastrës tek shumica e kulturave si edhe te kultura e lakrës në dozë prej 1l/ha. **ORVEGO** fungicid është shumë i mirë për shkatërrimin e prerjes së të fidanëve (*Pythium* spp). Në prodhimin e fidanëve përdoret edhe fungicidi **PROMESS** në dozë prej 25 ml/10l ujë. Një fungicid i ri modern dhe i dëshmuar i kompanisë **BASF** kundër bastrës është fungicidi **ENERVIN** i cili përdoret në dozë 2kg/ha. Ai është fungicid i kombinuar

sistematik i cili përdoret tek lloje të ndryshme kulturash gjatë gjithë vegjetimit. Për shkatërrimin e bastrës tek lakra dhe tek kulturat e tjera të kopshtarisë përdoret fungicidi sistematik **PROFILIX** në dozë prej 2,5 kg/ha ose fungicidi i njohur **ACROBAT** në dozë prej 2,5 kg/l. Si fungicid kontakt përdoret **DITHANE M45** në dozë prej 2,5 kg/ha. **SIGNUM** është fungicid sistematik parandalues me spektër të gjerë veprimi te lakra. Përdoret në dozë prej 1kg/ha. Përdoret kundër sëmundjeve të ndryshme siç është kalbëzimi gri, kalbëzimi i bardhë, njollat e zeza, njollat gri. Për parandalimin e kalbëzimit gri përdoret fungicidi me efikasitet të lartë **CANTUS** në dozë prej 1kg/ha. Për parandalimin e bastrës rekomandohen edhe fungicide bakri **CUPROZIN** dhe **FUNGURAN OH** dhe përdoren në dozë prej 3-5 kg/ha. Lakra përveç sëmundjeve kërpudhore mund të sulmohet edhe nga një numër i madh insektesh siç janë flutura e madhe (*Pieris rapae*), flutura e vogël (*Pieris rapae*), mola e lakrës (*Plutella* spp), vemja (*Plusia* spp), miza e lakrës. Për parandalim në këto insekte shërbimi profesional ofron insekticidin e ri sistematik me efikasitet të lartë **ALVERDE** i cili përdoret në dozë prej 1l/ha. Ky insekticid ka veprim kontaktues dhe digjestues tek insektet. **ALVERDE** është insekticid tërësisht i ri i kompanisë **BASF** i cili njihet me veprimin e përkryer mbi larvën në të gjitha nivelet edhe mbi shfaqjen e insekteve, si dhe ka përzgjedhje të jashtëzakonshme sipas kulturës së kultivuar. Mekanizmi i ri i veprimit të **ALVERDE** ushtron veprim të drejtpërdrejtë mbi enzimat dhe e bllokon qarkullimin e joneve nëpër kanalin e natriumit në sistemin nervor të insektit. Periudha e tërheqjes tek lakra është vetëm tre ditë. Një insekticid tjetër që rekomandohet për shkatërrimin e dëmtuesve te lakra është **NURELLE D** i cili përdoret në dozë prej 1l/ha, **PERFEKHTION** i cili përdoret në dozë prej 1-1,5 l/ha dhe **DASSKOR** në dozë prej 0,5-0,62 l/ha. •

Thartësira tek RRUSHI DHE VERA

Sheqerërat, thartësira dhe polifenolet si grupe të rëndësishme të përbërjes tek rrushi janë tre prej katër shijeve themelore: ëmbëlsinë, thartësinë dhe hidhësinë. Nëse do të ishin vetëm këto tre, të gjitha verërat do të ishin shumë të ngjashme dhe si rrjedhim – të mërzitshme

Shkruan: Mile Kostov

Gjatë vjeljes së rrushit pothuajse të gjithë janë të përqendruar tek përqindja e sheqerit, si përbërja me sasi më të madhe në lëngun e rrushit dhe si parametri më i rëndësishëm në përcaktimin e çmimit. Por, të gjitha përbërjet e rrushit e japin cilësinë përfundimtare dhe stilin e verës. Prodhuesi i verës mund të ndikojë në rezultatin e fundit, por nuk mund të fitojë cilësi nëse nuk ka lëndë të parë cilësore. Prandaj balanca e përbërjeve themelore të rrushit ka rëndësi të jashtëzakonshme për stilin e verës që do të merret. Shumë diell dhe ngrohtësi do të japë verë tek e cila ka mungesë të thartësisë, shumë alkool dhe e mefshtë. Nga ana tjetër, pak diell dhe ngrohtësi do të japë vera të pakëndshme, të holla dhe të tharta. Prandaj zgjidhja është balanca.

Përbërja e dytë themelore e rrushit është thartësira. Rrushi përmban thartësira natyrore të cilat mund t'i japin freski dhe ta mbajnë cilësinë e verës. Ato janë komponenti thelbësor i shijes. Thartësitrat prodhohen nga vetë rrushi. Dy thartësitrat kryesore në rrush janë thartësira e verës dhe mollës të cilat përfaqësojnë mbi 90% të thartësisë ose 5 prej 8 gr/l. Thartësira e verës nuk është kaq e zakonshme, kurse ajo e mollës është shumë e përhapur. Me rritjen e kokrrës, të dy thartësitrat zmadhohen në përqendrim deri në fazën e fillimit të pjekjes, kurse pastaj të dyja zvogëlohen kur akumulohen sheqerëra, thartësira e mollës zvogëlohet më shpejt. Ngrohja kontribuon për shpërbërje më të shpejtë të thartësisë së mollës.

Rrushi e përdor thartësinë e mollës si burim të energjisë. Në fazën më të vonshme ndodh edhe një transformim më interesant. Thartësira e mollës është e aftë të konvertohen në glukozë. Ky proces është i njohur si glikoneogjenezë – prodhim i ri i sheqerit. Aftësi të tillë ka edhe trupi i njeriut, kur glukozo mund të sintetizohet nga substancat e tjera kur trupi është në kushte të urisë ose me ushtrime të mundimshme. Thartësira e limonit është një tjetër thartësi por me

përdorimit përqendrimet e njëjta prej të dyjave, të anketuarit konsiderojnë se thartësira e verës është pjesërisht më e thartë se e mollës.

Mbi sasinë e thartësirave në rrush ndikimin më të madh e ka klima. Merrritjen e temperaturës, hardhitë dhe rrushi varren nga respirimi alkool më tepër sesa nga glukozo. Kjo është një përqindje evoluese që të ruhet sheqeri për farat. Mandej, ndikojnë pasqyrimi i rrushit, ndikimi i terrenit dhe karakteristikat e llojit dhe klonit të hardhive. Shembuj të llojeve me sasi të madhe të thartësisë së verës janë Rizling, Sulltana dhe Pallomino, kurse me sasi të madhe të thartësisë së mollës janë Malbek, Pino Noar dhe Shenin Blank.



përqendrim më të vogël (0,1 deri 0,5 gram për litër), pas së cilës vijojnë shumë thartësira të tjera në sasi më të vogël, siç janë: sucinik, glukuronik, glikolik, oksalik, salicilik dhe të tjera.

Në lidhje me shijen e thartë, thartësira e verës dhe mollës janë pothuajse ekuivalente. Kur do të krahasohen sipas thartësisë së tyre, ajo e verës është më e thartë, por kur të krahasohen sipas thartësisë titrimuese, ajo e mollës është më e thartë. Gjatë shumë degustimesh, gjatë

Por, vera është prodhim shumë më i thjeshtë, sepse rrushi është shumë kompleks në përbërje. Sheqerërat, thartësira dhe polifenolet si grupe të rëndësishme të përbërjes tek rrushi janë tre prej katër shijeve themelore: ëmbëlsinë, thartësinë dhe hidhësinë. Nëse do të ishin vetëm këto tre, të gjitha verërat do të ishin shumë të ngjashme dhe si rrjedhim – të mërzitshme. Për fat, ekziston edhe një e cila e jep shijen e veçantë të çdo lloji dhe çdo stili: komponentë aromatike. Ky është një grup i jashtëzakonshëm, kompleks dhe i gjerë i substancave të pranishme, të cilat mund të maten vetëm si pjesë të milionit, miliardave ose edhe më të vogla. Ato së bashku e përbëjnë aromën kryesore të verës, duke dhënë karakterin e llojit. Ato janë substanca të cilat përfshijnë esterë kompleksë dhe alkool të larta dhe të tjera. Por, kjo është temë e veçantë për diskutim lidhur me këtë prodhim magjik. ●

Kultivimi i LULESHTRYDHEVE TË MALIT



Me kultivimin e luleshtrydheve të malit, janë mundësuar të ardhura shumë mujore, stabilitet ekonomik dhe siguri në amvisëri me shpenzime minimale për prodhim.

Shkruan: Monika Risteska

Bashkëpunim në prodhimin e luleshtrydheve të malit

"Bashkëpunëtorëve tanë u japim mbështetje të tërësishme në lidhje me organizimin e prodhimit: trajnim, material për mbjellje, mbulesa për truallin dhe për mbulimin e fidanëve, sisteme për ujitje, rrjeta për hijezim, mjete mbrojtëse, mjete për ushqim, ambalazhe për paketim, shërbim këshillues, çmim të garantuar dhe blerje e sigurtë sipas marrëveshjes për bashkëpunim", thotë Zoran Radovanović kompania e të cilit jep mbështetje.

Prodhuesi mund të zgjedhë një prej modeleve të bashkëpunimit:

MODEL 1: Nëse filizat i paguan 100% me para të gatshme, çmimi i një filizi do të jetë 0,30 euro.

MODEL 2: Nëse filizat i paguan me fruta të luleshtrydhes së malit, çmimi për një filiz është 0,40 euro, me pjesë-marrjet të obligueshme prej 25% (përkatesisht 0,10 euro/copa), kurse 75%

të tjerat (përkatesisht 0,30 euro/copa) i paguan me fruta.

Mbulesat për tokën dhe për mbulimin e filizave, sistemet për ujitje, rrjetat për hijezim, mjetet mbrojtëse dhe ushqimi paguhen gjatë blerjes së filizave.

Të ardhurat e projektuara për 3 vitet e para:

- Viti i parë - 300 g/bimë
- Viti i dytë - 600 g/bimë;
- Viti i tretë - 300g/bimë.

"Në të dyja rastet, mbjellja e hershme pranverore dhe kushtet optimale për kultivim, investimi i tërësishëm kthehet gjatë vitit të parë të prodhimit madje me fitim. Çmimi ynë blerës për frutën e luleshtrydhes të malit për sezonin 2013 ka qenë 500 denarë/kg, përkatesisht 4,5 euro për kilogram. Çdo prodhuesi i është paguar sasia e tërësishme e frutës së blerë, me të njëjtin çmim, pavarësisht nga klasa", qartëson Zorani.



Teknologjia e prodhimit të luleshtrydhes së malit

"Luleshtrydhja e malit duhet të mbillet sa më herët që është e mundur në pranverë, kurse më vonë deri në qershor ose në vjeshtë të hershme që prodhimi në vitin e parë të jetë më i madh. Në vitin e dytë të kultivimit pritet prodhim i plotë. Është e nevojshme prodhuesit t'u përmbahen udhëzimeve tona dhe të përdoren vetëm mjetet tona për mbrojtje dhe ushqim që të sigurohen të ardhura të larta dhe cilësi e mirë e frutave. Ujitja dhe ushqimi jo i rregullt e zvogëlon prodhimin, si edhe tek çdo lloj tjetër bime dhe e shkurtojnë afatin e përdorimit të të mbjellave." thekson ai.

Për shkak të prodhimit më të madh, rekomandohet që të vendoset rrjetë për hijezim me efekt 35-40% të hijezimit. "Rrjeta do ta zvogëlojë rrezatimin diellor, do ta zvogëlojë temperaturën për 5-6°C, do t'i mbron mbjelljet nga breshëri, do të zmadhohet qarkullimi ajror dhe do të lehtësohet mbledhja nga punëtorët. Prodhimet zmadhohen me 30-50% me përdorim

të rrjetës për hijezim, kurse puna lehtësohet theksueshëm. Hijezimi i tërësishëm do ta eliminojë tharjen e të mbjellave gjatë vapës së madhe.", thotë Zorani. Rrjeta duhet të vendoset nga fundi i majit në shtylla druri me tel në lartësi prej 2 metrash. "Renditini në çdo 4-5 metra dhe kjo është më mirë direkt në radhët e luleshtrydhes së malit, sepse nëse vendosen në rrugicat do t'i pengojnë punëtorët gjatë mbledhjes dhe kalimit nëpër radhë. Nga ana e jugut dhe e perëndimit të të mbjellave, rrjeti të ulet me patjetër deri në tokë, që dielli të mos i ngrohë të mbjellat nga anash. Rrjeta të hiqet nga fundi i shtatorit ose fillimi i tetorit, në varësi nga kushtet kohore, kurse mund t'i mbrojë të mbjellat edhe nga ngricat më të vogla.", shton Zorani.

Kushtet natyrore më të përshatshme për kultivimin e luleshtrydhes janë rajonet kodrinore-malore me mbi 500 m mbi lartësinë e detit, përkatësisht aty ku mund të gjenden ekzemplarë të luleshtrydhes së malit. "Nuk rekomandojmë ngritje të të mbjellave nën 300 m mbi lartësinë e diellit. Në lartësitë më të vogla të detit është më e lartë popullata e insekteve të cilat i kalojnë viruset kur ushqehen me lëngjet e bimëve. Luleshtrydhja e malit është shumë e ndjeshme ndaj pranisë së viruseve të cilat ndikojnë në mënyrë direkt në uljen e prodhimit dhe kohëzgjatjen e të mbjellave. Prodhimtaria në serra nuk është e rekomandueshme për shkak të pranisë së madhe të insekteve të cilat në sera kanë kushte ideale për jetën dhe shumimin. Luleshtrydhet e malit spërkaten me vështirësi, për shkak të vëllimit të madh të gjetheve, i cili në serrë është shumë e brishtë. Gjatë verës do të ketë temperatura më të larta, kurse nëpërmjet kësaj edhe ndalim i lulëzimit dhe formimit të frutave dhe tharjen e bimëve.", shpjegon Zorani.

"Lokacioni i parcelave duhet të jetë në afërsi të shtëpisë edhe sipas mundësisë nën hije të brishtë ose me hijesim të siguruar edhe me ujë afër lokacionit për ujitje. Trualli duhet të jetë neutral (5-6,5 pH), pjellore, e shkrifët, kurse parakultura më të mira janë kulturat e livadhit ose tër-

fili. Në lokacionin e përzgjedhur (5 hektarë) të hidhen 2-3 rimorkio traktori pleh organik dhensh ose gjedhesh dhe të lërohet menjëherë. Trualli të shkriftohet, d.m.th. të lesohet dhe para lesimit të fundit të hidhet 50 kg pleh organik ITALPOLLINA 4:4:4, kurse sipërfaqja të spërkatet me solucion prej 25 l ujë, 100 g BOR (insekticid organik) dhe 50 g Trifender (preparat organik kundër sëmundjeve të truallit). Të lesohet për herë të fundit dhe pastaj të formohen leha dhe të vendosen zorra për sistemin pikë pas pike si dhe mbulesë mbi tokë, me dorë ose me makineri dhe të përforcohet, kështu që nuk do të ketë filluska ajri." thotë bashkëbiseduesi ynë. Nëse në mbulesë nuk ekzistojnë hapje për të mbjellat, është e nevojshme të bëhen me ndihmë të një cope plastike të mprehtë ose tub metalik me diametër prej 70 mm. Filizat vendosen në vrimë të hapur me dorë, në tokë me lagështi mesatare dhe mbulohen në të njëjtën lartësi ku kanë qenë në saks. Është shumë e rëndësishme filizi të mos mbillet thellë, përkatësisht qafa e rrënjës të jetë mbi tokë. Pas mbjelljes, çdo filiz të ujitet me 0,2 ushqim (10 gr pleh 10:40:10 në 10 l ujë). Pastaj trualli të ujitet mirë me sistemin pikë pas pike. Procedura për ujitje me ushqim të përsëritet pas 7 ditësh", përfundon Zoran Radovanović.

Ushqimi i luleshtrydheve kryhet me ujitje dhe me spërkatje foliare. "Pleherimi nëpërmjet ujitjes kryhet me sistemin pikë pas pike, çdoherë me përqendrim prej 0,1%, herë pas here me plehra 20:20:20 dhe 4:10:40 (2 kg ushqim në 2000 l ujë në 5 hektarë). Ushqimi foliar kryhet 1-2 herë në javë me përqendrim 0,3%, me pleh të lëngshëm HUMISUPER dhe me Calcium organo 30 (150 gr ushqim në 25 l ujë për hektarë). Spërkatja kryhet në orët e pasdites 1-2 orë pas perëndimit të diellit ose maksimum 3-4 orë para shiut. Ujitja dhe ushqimi kryhen menjëherë pas vjeljes në orët e hershme të mëngjesit ose në orët e vona të mbrëmjes, pa e tepruar me ujitje. Ujitja optimale është 0,5 deri në 1 l ujë për bimë, në varësi nga lloji i tokës", thotë Zorani.



Mbrojtja dhe kujdesi për luleshtrydhen e malit

Mënyra më e mirë për mbrojtjen e luleshtrydhes së malit dhe kjo "për truall me sipërfaqe prej 5 hektarësh gjatë vitit 2-3 herë që të ujitet me sistemin pikë pas pike, me solucion prej 200 g Triferender dhe 400 ml Kingbo me rreth 2000 l ujë. Është shumë e rëndësishme (një herë në javë) heqja e gjetheve të vjetra dhe të dëmtuara, që të anashkalohet transferimi sëmundjeve, që të mundësohet ajrosje më e mirë, shumimi me llastarë dhe pjalmim. Mirëmbajtja e rrugicave midis leheve, kryhet më mirë vendosje të tallashit prej ahu ose bredhi ose me kashtë, me një shtresë në trashësi prej 3-5 cm ose me tëharrje me dorë" përfundon Zorani.

Mbledhja dhe magazinimi i frutave të luleshtrydhes së malit

Mbledhja e frutave cilësore dhe të pjekura kryhet në çdo 3-5 ditë, në arka plastike për malina, maksimum 1kg për arkë. "Frutat menjëherë pas mbledhjes në arkë vendosen në frigorifer i cili përdoret vetëm për ngrirje të luleshtrydhes së malit. Pas 24 orësh frutat e ngrira vendosen me kujdes në kuti me qese plastike, të mbyllet qesja, të ngjitet kutia dhe të magazinohet në ngrirës derisa të merren", shton Zorani.



Largësia e drejtë midis fidanëve

Shkruan: dipl. inxh.agr. Ivan Stojanov
dipl. inxh.agr. Kostadinka Vasilevska

Arra mbillet në të gjitha rajonet me ngrohtësi mesatare. Sistemi rrënjor është i degëzuar dhe i fortë, rrënja kryesore futet thellë në tokë deri në 3-5 metra. Sistemi karakteristik mundëson në rrënjët anësore të formohen edhe rrënjë vertikale, si në thellësi ashtu edhe në sipërfaqen e tokës, kështu që e thithin me lehtësi ujin dhe materiet minerale.

Trungu i arrës në një vend qëndron 50 deri në 100 vjet, në varësi nga kushtet natyrore për rritje të saj. Në këto kushte futet edhe mënyra e përgatitjes së truallit për mbjellje. Largësia gjatë mbjelljes së arrave është e ndryshme si për vetë rreshtin ashtu edhe ndërmjet rreshtave. Çdo lloj dhe truall ka ndikim të madh në këtë proces. Por, shkurtimisht disa fjalë për masat agroteknike të domosdoshme për vetë procesin e mbjelljes. Përgatitja fillon me pastrimin e terrenit, lërim të thellë, plehërim, rigolovanje dhe hapjen e vrimave.

Kohët ndryshojnë. Dikur arrat janë mbjellë në largësi të mëdha për shkak të llojeve, sorteve dhe truallit. Pazari kërkon lloje të reja, sidomos lloje me lëvozhga të bardha, të mëdha, me përqindje të madhe të materieve të thata dhe yndyrë, që përdoren për ushqim dhe përpunim. Arrat duhet të mbillen në largësi të mjaftueshme, kështu që në një njësi sipërfaqeje të mbillen fidanë të cilët nuk do të krijojnë hijezim i cili do të ndikojë negativisht mbi prodhimin.

Zhvillimi duhet të mundësojë zhvillim normal, maksimal të kurorës, kështu që duhet të ketë dritë të mjaftueshme kurse trungu t'i ketë të gjithë faktorët e kënaqshëm të një hapësire ushqyese. Nga të gjithë faktorët e mundshëm prej të cilëve varen, më e rëndësishmja është largësia midis tyre, kurse gjithsesi edhe kurora që duhet të formohet, forma që duhet të ketë fruta e ardhshme, trualli dhe lloji i mbjelljes.



Duhet të kihen parasysh faktorët të cilët ndikojnë në largësinë, sipërfaqet, karakteristikat e truallit, formën e kurorës, karakteristikat gjenetike - biologjike të llojeve, kushtet gjeologjike të rajoneve ku ngrihen kopshtet





Në prodhimtarinë bashkëkohore, ku mekanizimi ka fjalën kryesore dhe largimi nga mendimet tradicionale se arra si frutë kërkon hapësirë më të madhe për njësi sipërfaqeje duhet të kihet kujdes për shkallën e intensitetit ose kultivimit dhe dedikimit në prodhimtari. Duhet të kihen parasysh faktorët të cilët ndikojnë në largësinë, sipërfaqet, karakteristikat e truallit, formën e kurorës, karakteristikat gjenetike-biologjike të llojeve, kushtet gjeologjike të rajoneve ku ngrihen kopshtet.



PSE ARRA TË SHARTUARA?



Përparësia e arrës së shartuar nuk është vetëm cilësia e frutës, por edhe futja e shpejtë në prodhim. Pas mbjelljes ajo jep prodhim shumë shpejt, disa lloje të caktuara prodhojnë që në fidanishte, për shembull, lloji Çendler;

Nëse arrat e tjera prodhojnë nga viti i 6 deri të 8, arra e shartuar prodhon që në vitin e parë. Por, mos mendoni se ai prodhim është prodhim që konsumohet, ose se mund të keni prodhim të mjaftueshëm për shitje. prodhimi i vitit të parë dhe të dytë hidhet, kurse i vitit të tretë deri në vitin e pestë janë vjelje më serioze;

Arra e shartuar ka vegjetacion më të shkurtër, kështu që ngricat e vonshme pranverore dhe ngricat e hershme vjeshtore nuk mund t'i dëmtojnë sythat. Prodhimi i ri i arrës reziston deri në temperaturë prej -10C, kështu që me përzgjedhjen e llojeve duhet të kihet kujdes dhe duhet të përzgjidhen lloje për shartim të arrës që fillojnë më vonë me vegjetimin;

Me zbatimin e masave agroteknike përkatëse, me ushqim të mirë dhe me ujitje, arra e shartuar prodhon rregullisht, kurse e gjitha kjo jep fitim rregullisht;

Llojet e përzgjedhura duhet të jenë më rezistente ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve, kurse rekomandohet mbjellje e llojeve të cilat pjalmohen midis tyre, si për shembull llojet Çendler, Franket, Fernor, Fernet dhe të tjera.



Që të llogaritet numri i fidanëve për njësi sipërfaqeje (ha) së pari llogaritet sa hapësirë zë një fidan dhe pjesëtohet me sipërfaqen prej 1 ha.

Për shembull, largësia midis fidanëve nëse është 6x5 m. 1 fidan zë rreth 30 m². Për sipërfaqe prej 10.000 m² do të nevojiten 333 fidanë ose matematikë e thjeshtë 10.000 : 30 = 333. Procedurat për gjetjen e numrit të fidanëve në katror dhe formë drejtkëndore është e njëjtë nëse

shumëzohet largësia midis rreshtave me largësinë midis pemëve. Nëse bëhet fjalë për trekëndësh, numri i fidanëve është më i madh se 15% dhe numri do të jetë 383 fidanë.

Nëse largësia është 7x7 për llojet të cilat momentalisht kërkohen në treg, kurse largësia nga një resht te tjetri është 7m në një sipërfaqe prej 1 ha duhet të mbillen 200 fidanë. Respektojini faktorët e jashtëm të cilët ju garantojnë sukses. ●





LAJTHIA - kultura bujqësore më fitimprurëse

Shkruan: Bllagojçe Najdovski,
Monika Risteska

Ndryshimet klimatike tashmë janë realitet dhe bëjnë ndryshime globale në sektorin e bujqësisë. Fakti se disa kultura bujqësore janë përqendruar në rajone të caktuara në botë të cilat janë goditur nga ndryshimet klimatike shkakton probleme të paparapara në furnizimin e tregut me ato kultura. Një nga shembujt më drastikë është prodhimi i lajthisë, kështu në Republikën e Turqisë janë prodhuar mbi 75% të sasisë

Nuk ekziston asnjë lloj frute tjetër që rritet në pemë, kurse e ka çmimin për një kilogram si për një kilogram kaçkavall. Në përputhje me potencialin gjenetik të lajthive ku pemishtja me lajthi në vitin e shtatë prodhon dy ton lajthi të paqëruara për hektarë, kurse në praktikë kjo do të thotë se çmimi mbetet i njëjtë dhe mund të fitoni të ardhura prej 10.000 eurosh për hektar.



së përgjithshme në nivel botëror dhe aty kjo prodhimtari është përqendruar kryesisht në rajonin e Detit të Zi në këtë shtet, kurse pikërisht ky rajon është goditur nga ndryshimet klimatike të cilat manifestohen me fatkeqësi klimatike ekstreme siç janë breshëri, ngrica e vonshme, të cilat e ulin dhe jetë herë prodhimin në dy sezonet e mëparshme. Prandaj çmimi i lajthisë në nivel global shkoi deri në qiell, kështu tani një kilogram në shitjen me pakicë në R. e Maqedonisë shitet me çmim prej 20 eurosh, kurse çokollatat dhe prodhimet e tjera konditore, të cilat përmbajnë lajthi e dyfishojnë çmimin e vet edhe në nivel global ndjehet mungesë e këtij prodhimi bujqësor.

Kështu kompania italiane "Ferro" prodhues i brendit "Nutella" në gusht të këtij viti paralajmëroi se rezervat e lajthive janë nga fundi dhe për shkak të mungesës së këtij prodhimi në treg mund të kenë problem të prodhojnë sasi të mjaftueshme prodhimesh. Po, nuk është gjithçka kaq e zejë nëse mbështetemi te fjalët popullore "nëse dikujt i errësohet tjetrit i zbardhohet". Lajthia, si kulturë bujqësore, u bë shumë interesante për fermerët. E gjithë kjo e bën lajthinë një nga kulturat më fitimprurëse në bujqësi, kurse tek fermerët ka një interes gjithnjë dhe më të madh për mbjelljen e kësaj kulture. Nuk ekziston asnjë lloj frute tjetër që rritet në pemë, kurse e ka çmimin për një kilogram si për një kilogram kaçkavall.

Fisnik Dika nga fshati Ame, Rrethi i Dibrës ka pemëtari lajthish prej 5.000 metrash katrorë me lajthi në shpatet e fshatit Ame në afërsi të Banjave të Dibrës. "Dëshira që t'u lë diçka gjeneratave të ardhshme dhe çmimi i përshtatshëm më stimuloi të mbjell pemishte me lajthi", thotë Dika. "Kam dy parcela me lajthi. Një njëren parcelë pemishtja është dyvjeçare, kurse në parcelën tjetër pemishtja është trevjeçare dhe këtë vit për herë të parë dha prodhim. Prodhimi nuk është i madh, por cilësia e lajthive është e përkryer", shton Dika.

"Në tri vitet e para të zhvillimit të filizave me rëndësi të madhe është të sigurohet ujitje e rregullt, që të mundësohet zhvillim i drejtë i lajthisë. Ujitja është e nevojshme nga maji deri në shtator në përputhje me nevojat e bimës dhe pse vendosa sistemin pikë për pikë, megjithatë rezultate më të mira mora me ujitjen me brazdë sepse afër pemishtes janë Banjat e Dibrës dhe ka ujë me bollëk", shpjegon Dika. "Pemishtja e lajthive është pemishte organike e certifikuar dha që të fitoni lajthi organike duhet të respektoni disa



rregulla të caktuara paraprakisht të cilat ekzistojnë në prodhimin organik, si për shembull, nuk duhet të përdorni plehra artificiale dhe herbicide, kështu që barërat e këqija midis radhëve i pastrojmë me dorë. Kemi mbjellë dy lloje lajthish. Lloji kryesor është ai italian Tonda xhentile romana, kurse për pllenim e përdor llojin italian të lajthive Romane", thotë Fisnik Dika.

"Për shkak të faktit se në afërsinë time nuk ka pemishte të tjera dhe nuk ka fermerë të tjerë të cilët kanë pemishte lajthie, nuk kemi përvojë praktike në kultivimin e kësaj kulture dhe këshilluesi im më i madh është interneti. Filizat i mora në Shkup me çmim prej 4 eurosh për filiz. Matematika është shumë e thjeshtë dhe raporti është një filiz kushton sa një kilogram fruta, kurse pemishtja ka afat deri në 70 vjet dhe do ta trashëgojnë edhe pasardhësit tuaj", shton Dika.

Lajthia është kulturë shumëvjeçare e cila është relativisht rezistente ndaj sëmundjeve dhe temperaturave të ulëta, kurse prodhim të plotë jep pas gjashtë vjetësh. Lajthia ka çmim stabil të blerjes. Momentalisht këtë vit për llojin Tonda xhentile çmimi për kilogram është 5 euro në shitjen me shumicë për një kilogram lajthi të paqëruar.

Në përputhje me potencialin gjenetik të lajthive ku pemishtja me lajthi në vitin e shtatë prodhon dy ton lajthi të paqëruara për hektarë, kurse në praktikë kjo do të thotë se çmimi mbetet i njëjtë dhe mund të fitoni të ardhura prej 10.000 eurosh për hektar. Kjo e bën një nga kulturat më fitimprurëse nëse merret parasysh fakti se lajthia kërkon agroteknikë dhe mbrojtje minimale, mund të nxir-

ret konkluzioni se lajthia është kulturë për fermerët. Duke pasur parasysh jetëgjatësia e pemishtes është nga 30 deri në 50 vjet, ajo është burim afatgjatë i të ardhurave, kurse nëse merret parasysh rroga mesatare në Republikën e Maqedonisë është 300 euro në nivel vjetor, vini te përfundimi se ajo është kulturë ideale për vetëpunësim të fermerëve të rinj në mjediset rurale.

"Dibra është qytet emigrantësh me një numër të madh të të rinjve të papunësuar dhe pemishtja me lajthi është një nga mënyrat të rinjtë të vetëpunësohen dhe të mund ta zgjidhin ekzistencën e vet jetësore. Shpenzimet për mbjelljen e një hektari nuk janë shumë të mëdha, kështu që për ngritjen e pemishtes nevojiten rreth 25.000 euro për hektar, ku futen shpenzimet për blerje të: filizave, për lërim të sipërfaqes, analizë të tokës dhe shpenzimet e mbjelljes. Por sipas meje, një prej gjërave më të rëndësishme është të siguroni sipërfaqe me sasi të mjaftueshme uji për ujitje", shton Dika.

"Lajthia si kulturë kërkon mbrojtje minimale nga sëmundjet dhe dëmtuesit. Unë këtë sezon pemishten me lajthi e kam trajtuar vetëm njëherë kundër dëmtuesve dhe në krahasim me kulturat e tjera, si për shembull, molla, lajthia është edhe më interesante sepse është i përshtatshëm për prodhim organik. Është shumë e rëndësishme mirëmbajtja e pemishtes dhe është e nevojshme ujitja e rregullt. Lajthia kërkon shumë ujë, por afërsia me Banjat e Dibrës dhe uji i bollshëm kontribuuan që pemishtja të jetë në kondicion të përkryer. Dhe për në fund, lajthia ndoshta është medikamenti për mbajtjen e popullatës së re në mjediset rurale." ●

Si të kultivohet drejt **ARONIA?**

Aronia nuk është kulturë e që kërkon kujdes të madh. Ajo nuk duhet të spërkatet dhe nuk ka kërkesa specifike në lidhje me tokën dhe klimën, kurse e duron thatësinë dhe temperaturat shumë të ulëta.

Shkruan: Ivica Velinov

Aronia është pemë me formë të rrumbullakët e cila më tepër ngjason me një frutë të boronicë dhe prandaj e quajmë boronica siberiane. Ajo është bimë me formë të shkurre. Fruta e saj hahet, ka vepër shumë të dobishëm dhe mund të vilet edhe dy muaj pas pjekjes. Aronia nuk ka nevojë të spërkatet sepse nuk mund të sëmuret apo të zërë mora. Aronia është kulturë e cila nuk përzgjedh shumë në lidhje me kushtet klimatike dhe të tokës. Ajo adaptohet edhe në klimë të thatë edhe në klimë të lagësht, por rezultatet më të mira i jep në rajone me lagështi mesatare të ajrit dhe tokës. Gjatë dimrit pjesa mbiotkësore duron temperatura nga -30 deri në -35 gradë celsius. Në kushtet tona rrallë ndodhin temperatura të tilla, prandaj parë në këtë aspekt, kjo kulturë është tërësisht e sigurt nga ngricat gjatë dimrit. Për zhvillim optimal të shkurreve gjatë vegjetacionit, është e nevojshme temperatura të jetë mbi 100C nga 120 deri në 150 ditë pa shfaqje të ngricave.



Për kultivim me sukses të kësaj kulture dhe për arritje të të ardhurave optimale dhe cilësore, sasia e reshjeve gjatë periudhës së ngrohtë të vitit (në kushtet tona qershor-shtator) duhet të jetë mbi 200 deri 300mm, kurse në të kundërt duhet të sigurohen kushte për ujitje. Në raport me tokë, nuk është ndonjë përzgjedhës i madh, arrin të bëhet edhe në toka ranore por edhe në toka gline. Nuk janë të përshtatshme toka ndaluara dhe në kënetat. Ujërat nëntokësore nuk duhet të jenë më të cekëta se 1,5 deri 2m. Që të lehtësohet kultivimi i aronisë, baza për shartim duhet të jetë e vjetër minimum tre vjet, sepse shartohet në lartësi prej 100 deri 120 cm. Për shkak të zhvillimit mjaft të ngadalshëm të kalemave, të cilët janë mjaft të shtrenjtë, më shpesh kultivohet në rrënjën e vet si shkurre dhe asaj mund t'i jepet formë me krasitje, që të mos lejohet rritje e madhe e kërcejve, që të sigurohet fotosinteza normale e të gjitha gjetheve dhe të sigurohet prodhim i mirë.

Përgatitja e tokës për mbjellje

Për mbjelljen e aronisë, toka duhet të lërohet thellë dhe të përpunohet mirë. Përpunimi në thellësi i tokës kryhet në dy mënyra: me rigolim (me ndihmë të rigolerit) ose me dredhje të thellë (me ndihmë të llojeve të ndryshme të makinerive për dredhje). Në disa lloje të tokave mjafton të bëhet dredhje ose vetërigolim, kurse te disa toka të tjera të forta, është e nevojshme të kryhet dredhje dhe pastaj rigolim. Tek të gjitha mënyrat e përpunimit të thellë të tokës, thelbësore është toka të jetë e ajrosur dhe e shkrifët mirë. Përpunimi i thellë i tokës ku do të ngrihet fidanishtja duhet të kryhet në thellësi nga 40 deri

në 70 cm. Më shpesh, thellësia e përpunimit varet nga lloji i tokës dhe nga kushtet klimatike.

Dendësia e mbjelljes: skema

Mbillet në vjeshtë, gjatë dimrit dhe pranverës së hershme, me kusht që toka të mos jetë e ngrirë dhe të mos ketë nisur vegjetimi. Më shpesh mbillen bimë njëvjeçare dhe dyvjeçare. Dendësia më e mirë për mbjellje, nëse vilet me dorë, është 3 x 1,5 m dhe në një hektar me këto dimensione mbillen 2.222 bimë. Nëse vilet me makineri, mbillet në largësi prej 4 x 1 m dhe në një hektar me këto dimensione mbillen 2.500 bimë.

Mbjellja e saktë

Madhësia e sistemit rrënjor është 20-30 cm, rekomandohet shkurtim i rrënjës dhe gjatësia e sistemit rrënjor të jetë 15-20 cm. Hapet një vrimë me dimensione minimale 40 x 40 x 40. Parapëlqehet të shtohet material organik ose plehra organike. Mbillet në thellësi në të cilën ka qenë në fidanishte – thellësi prej 20 cm. Fidani mbulohet me kujdes me dhe të imët dhe të lagësht dhe shkelet rreth tij që të ketë kontakt më të mirë të rrënjës me tokën, kurse në këtë mënyrë të dalë edhe ajri. Nëse toka gjatë mbjelljes është e thatë, duhet të laget që të pengohet procesi i dehidrimit, sepse toka e thatë e thith ujin e rrënjës dhe kështu do të thahet bima para se të nisë të rritet.

Ujitja

Nuk ujitet kur ja diell të fortë. Pasdite vonë apo herët në mbrëmje është koha më e keqe për ujë!!! ●



MOLLË SHTYLLLORE


- dekoruese, por prodhuese

Shkruan:

Dipl. inxh. agr. Llambe Kucinoski

Mollët shtylllore arrijnë shpejt deri në prodhim, kështu që frutat e para mund të formohen që në vitin e parë të mbjelljes. Në fidanët e klasës së parë sythat e luleve formohen që në rritjen njëvjeçare, prandaj duhet kihet kujdes që këta sytha të mos shkatërrohen gjatë transportit. Në vitin e dytë dhe vitet në vijim mollët shtylllore fillojnë të japin prodhim serioz, i cili në vitin e pestë duhet të mbahet në 10-15 kg për pemë.

Mollët shtylllore janë risi e cila mundëson kultivimin e një numri të madh pemësh për njësi sipërfaqeje (10.000 peme për ha). Pemët karakterizohen me faktin se kanë kurorë të drejtë e cila nuk degëzohet në mënyrë natyrore. Për shkak të rritjes së vet të dobët vegetative ato nuk zënë shumë vend. Prandaj mund të kultivohen edhe në saksimë të mëdha, të cilat mund të lëvizin sipas nevojës nga një vend te tjetri.



Mollët shtylllore kultivohen në largësi prej 50 cm në rradhë, mund të mbillen në një rresht, dy rreshta ose tri rreshta, me largësi 50 cm midis rreshtave. Gjatë vegjetimit nuk duhet të ujitën shpesh, por vetëm atëherë kur të vlerësojmë se ka deficit të lagështisë në truall. Norma e ujitjes duhet të jetë 40-50 l/m. Nevoja për krasitje është minimale dhe kryesisht është rrallim i sythave të luleve me shkurtim të kulaçit prodhues. Lastarët njëvjeçarë të formuar rastësisht më të gjatë se 10 cm që mund të shfaqen në elementet prodhuese ku kemi të formuara edhe sytha lulesh, i heqim në bazë. Nëse, lastari njëvjeçar shfaqet drejtpërdrejt të mbartësja në vendin ku nuk është formuar kulaç prodhues, e rrallojmë në 2-3 sytha dhe në këtë mënyrë i rinovojmë kulaçet prodhues dhe formojmë të reja. ●



Sistemi Bibaum për kultivim të mollëve

Teknologjitë e reja në pemëtari, të cilat zbatohen shumë në botë, ngadalë po vijnë edhe tek ne. Edhe pse jemi skeptikë për disa risi të caktuara, që t'i arrijmë standardet botërore në prodhimtari, është e domosdoshme që të adaptohemi dhe t'i pranojmë sa më shpejt teknologjitë e reja të kultivimit.

Shkruan:
dipl. inxh. arg Llambe Kicinoski

Sistemet **Bibaum** të kultivimit të mollëve në Itali nuk janë diçka e re, kurse për pemëtarët tanë këto sisteme të kultivimit janë tërësisht të panjohura. Në bazë, bibaum, është sistem i kultivimit ku **nga një kalem** nxirren dy degë. Sistemi **Bibaum** ka shumë përparësi, si për shembull, qasje më e lehtë te vetë pema, që mundëson krasitje, spërkatje dhe vjelje më të lehtë. Gjatë këtij sistemi madje edhe ata të cilët nuk kanë përvojë në krasitje mund ta kryejnë lehtë këtë punë. Efikasiteti i vetë fuqisë punëtore gjatë vjeljes zmadhohet me 20%, kurse përparësi edhe më e madhe është fakti se pemët në këtë mënyrë kultivimi janë më produktive. Merret një cilësi e mirë dhe prodhim më i lartë. Cilësia e frutave është e njëtrajtshme në të gjithë pemën (nga maj deri poshtë), sepse fruta merr më tepër dritë kurse dendësia e kurorës është më e vogël.



Sistemi Bibaum i kultivimit jep rezultate më të mira në truaj cilësore në kushte me klimë mesatarisht të lagësht. Në truaj me cilësi të dobët prodhimi mund të jetë më i dobët. Një

tjetër përparësi për këtë sistem të kultivimit është edhe fakti se ai siguron qasje të mirë për mekanizimin në vetë kopshtin e pemëve, bëhet më thjeshtë rrallimi dhe heqja e luleve. Kemi homogjenitet më të madhe në cilësinë e frutave, pastaj kemi sipërfaqe më të vogël për spërkatje dhe si rrjedhim edhe më pak mjete kimike.



Qëllimi kryesor i kultivimit të mollëve me një sistem të tillë është zmadhimi i qëndrueshmërisë ekonomike dhe ekologjike, kurse të zvogëlohen edhe shpenzimet për mbrojtje dhe fuqia punëtore. Përqindja e frutave të klasës së parë në **sistemin bibaum** është më e madhe sesa në **sistemin spindel**, kurse mënyra e krasitjes është më e ndryshme. Tek **sistemin spindel** kryhet një krasitje më e gjatë, përkatësisht bëhet krasitje centrifugale, kurse tek **sistemin bibaum** krasitja është centripetale, d.m.th. degët janë të kthyera drejt trungut. ●



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE




Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,
Education and Research EABR
State Secretariat for Economic Affairs SECO

PROJEKT PËR ZGJERIM TË BIZNESEVE TË VOGLA

Ringjallje e prodhimit të broilerëve në Maqedoni me sistemim e ujitjes pikë për pikë

Shkruan: Ivan Mickovski,
Projekt i USAID-it
për zgjerimin e
bizneseve të vogla



Një nga shkaqet e rënies së prodhimit të broilerëve është mungesa e ushqimit të lirë për shpendët i cili do ta zmadhonte rentabilitetin e fermave të pularisë. Sistemi pikë për pikë për prodhimin e misrit do ta zmadhojë rentabilitetin e prodhimit të broilerëve. Vetëm me një hektar pikë për pikë Kërste këtë vit do të kursejë 94.400 denarë.

Prodhimi i broilerëve, përkatësisht prodhimi i mishit të pulës, zë një përqindje më të madhe të prodhimit të përgjithshëm të mishit në botë. Për fat të keq, prodhimi i broilerëve në Maqedoni në disa vitet e fundit shkon në drejtim të kundërt. Kurse në vitin 2003 në Maqedoni janë prodhuar 3.500 tonë mish pule, deri në vitin 2013 (periudhë për të cilën janë në dispozicion të dhënat) prodhimi ka rënë në vetëm 250 tonë mish pule. Këto të dhëna e renditin Maqedoninë në vendin e fundit për prodhimin e mishit të pulës në Ballkan. Trendi i tillë nuk ndodh për shkak të kërkesës së ulët sepse në Maqedoni vitet e fundit janë importuar nga 28.000 deri në 30.000 ton mish pule, që shtetin e kush-ton rreth 40 milionë euro në vit.

Një nga shkaqet e rënies së prodhimit të broilerëve është mungesa e ushqimit të lirë për shpendët i cili do ta zmadhonte rentabilitetin e fermave të brojlerëve. I vetëdijshëm për këtë problem, Kërste Jovanov, pronari i një prej dy fermave të fundit të broilerëve në Maqedoni, punon me shumë mund për prodhimin e misrit për ushqim për shpendët. Ai këtë vit për herë të para filloi të kultivojë misër të ujitur me sistemin pikë për pikë në fermën e vet në Krivollak. Sistemin e ka marrë si donacion nga Projekti i USAID-it për zgjerim të bizneseve të vogla me qëllim që të dëshmojë se kjo metodë e ujitjes mund ta zmadhojë rentabilitetin e prodhimit të broilerëve. "Dallimi kryesor me sistemin qëndron në faktin se k[tu] uji bie në mënyrë natyrore, kurse nëpërmjet brazdave duhet ta ujisim tokën derisa të mbyllet të gjitha poret, që ndikon në krijimin e kushteve më të këqija për vegjetim sesa pikë për pikë. Dallimi është i madh. Me pikë për pikë përdoret edhe më pak ujë, kurse me sistemin klasik nuk kemi kontroll të sasisë së ujit", thotë Kërste.

Falë përvojës së tij 10-vjeçare në prodhimin e broilerëve dhe kohën e kaluar si drejtor në disa thertore në Maqedoni, Kërste e di rëndësinë e ushqimit të



Në vitin 2013, në Maqedoni filloi procesi i modernizimit të prodhimit të misrit nëpërmjet përparimit të ujitjes dhe plehërimit të kulturës me sistemin pikë për pikë. Projekti i USAID-it për zgjerimin e bizneseve të vogla në suazat e iniciativës “Të kultivojmë më tepër misër” vendosi 280 sisteme për ujitje pikë për pikë në parcelat prej një hektari që ta demonstrojë efektivitetin e sistemit në rritjen e prodhimtarisë. Pjesëmarrësit në këtë iniciativë arritën të kenë të ardhura mesatare për



libër për shpendët. Ai çdo vit importon rreth 120 ton misër nga Serbia për fermën e vet me kapacitet prej 12.000 broilerësh. Këtë vit për herë të parë Kërste e prodhon vetë një pjesë të misrit që i nevojitet. Edhe pse parcela e tij është me truall ranor e klasës së ulët, me ndihmë të sistemit pikë për pikë Kërste arriti të prodhojë 8 ton misër për hektar. Këto të ardhura janë të jashtëzakonshme për kushtet në Krivollak, të ardhurat mund të zmadhohen me përdorim të mekanizmit bashkëkohor siç janë makinat mbjelëse pneumatike.

Me çmimin e shitjes prej 16 denarësh për kilogram, Kërste ka shpenzuar 128.000 denarë për të njëjtën sasi misri. Me sistemin pikë për pikë, çmimi i prodhimit të misrit për Kërsten është 4,2 denarë, ose 33.600 denarë për 8 ton. Vetëm me një hektar pikë për pikë, Kërste këtë vit do të kursejë 94.400 denarë. “Këto 8 ton që do t’i prodhoj do të më ndihmojnë shumë sepse nuk duhet t’i blej nga Serbia me çmim prej

15-16 denarësh.”, thotë ai. Duke pasur parasysh se me sistemin pikë për pikë mund të arrihet prodhim edhe prej 20 tonësh për hektar, Kërste pret të kursejë edhe më tepër në të ardhmen nëpërmjet zmadhimit të prodhimit dhe vendosjen e sistemit në sipërfaqe më të madhe. Ai shpreson se me dy hektarë misër pikë për pikë mund të sigurojë 20 ton fara, ushqim i mjaftueshëm për një turn prej 10.000 zogjsh. Që të përshpejtohet zmadhimi i fermës së vet, ai në vitin 2016 dëshiron të aplikojë për kofinancim të sistemit pikë për pikë për misër nga programi 50/50 nëpërmjet të cili Ministria e Bujqësisë kryhen kthim të 50% të investimit në këtë teknologji. Përveç mbështetjes financiare për sistemet pikë për pikë të misrit, sipas paralajmërimeve zyrtare nga Ministria e Bujqësisë, në të ardhmen e afërme do të stimulohet prodhimi i bojlerëve me masën për kofinancim të rikonstruksionit dhe hapjes së fermave të reja për prodhim të broilerëve. ●

kokërr misri prej 13 t/ha me ujitje dhe plehërim nëpërmjet sistemit pikë për pikë. Sistemet pikë për pikë mundësojnë prodhim të kokërrës edhe deri në 20 t/ha, por nëse në vetëm 7.000 hektarë arrihet prodhim mesatar prej 13 t/ha Maqedonia mund ta zëvendësojë importin e misrit me prodhimin vendas deri në vitin 2020.





Shkruan:

Dipl. inxh. agr. Jelica Beshliq

Sharole (Charollais) është dele e racës franceze për majmëri. Ajo është dele me madhësi të mesme, me ngjyrë të bardhë, e majme dhe me rritje të hershme, pa brirë dhe me lesh të mirë. Trupin e ka të gjatë dhe me formë ovale, me thellësi dhe gjatësi të mira. Këmbët i ka të zbathura, pa lesh dhe të shkurtra me ngjyrë si fytyra, por asnjëherë nuk janë me ngjyrë të errët. Bashka e leshit është e mbyllur dhe me ngjyrë të bardhë me lesh të mirë trashësia e qimes së tij është 29 mikronë. Ka kocka jashtëzakonisht të lehta dhe të mira të cilat janë të mbushura me mish me cilësi të përkryer.

- Performancat prodhuese:
- Pesha e dhenve të rritur: desh 100 – 150 kg; dele 80 – 100 kg;
- Randmani i mishit është 60%;



- Sasia e leshit të marrë: kokë meshkuj 2 – 2,5 kg, femra 3 – 4 kg me gjatësi të qimes prej 4 deri në 6 cm;
- Pjelloria: 100 dele në vit linden 180-200 shqerra, me përqindje të madhe të binjakëve i cili varet nga sezoni i mbarështimit;
- Rritje e hershme: shelegët hyjnë në periudhën e mbarështimit që 7 muaj me pjellori mesatare prej 130%;
- Rritja nga 380 deri në 500 gram në ditë.

Delja sharole është “krijuar” për majmëri dhe duhet t’i jepet rëndësi më e madhe si për mbarështim të pastër ashtu edhe për programe kryqëzimi. Janë vërtetuar rezistenca, qëndrueshmëria dhe përshtatja e saj me kushtet tona të ndryshueshme klimatike. Edhe pse është pak më e shtrenjtë për kushtet tona, duhet t’i jepet shans për rritje, sepse është me randman të lartë, me mish shumë cilësor. Rekomandohet të kultivohet në rajone të ulëta, më të ngrohta me eksploatim ekstensiv. Gjithashtu e karakterizon pjellori e përkryer, instinkt i nënës dhe mbarështim i lehtë dhe rritje e madhe e shqerrave.●

Norma e rritjes së shqerrave	Pesha mesatare e shqerrave	Rritja mesatare 0 - 56 ditë
Shqerra meshkuj:	kg	gr/ditë
një	5,0	500
binjakë	4,5	420
Shqerra femra:	kg	gr/ditë
një	4,7	395
binjakë	4,3	380



Gaze të dëmshme në stallë

Që të jenë të shëndetshme dhe produktive, kafshët duhet të kenë ajër të pastër të mjaftueshëm të pasur me oksigjen. Mënyra më e mirë që të rregullohet niveli i gazrave të dëmshëm në stalla është vendosja e ventilimit të mirë.

Shkruan: Dipl. inxh. agr. Jelica Beshliq

Përbërja e ajrit në stallë ndryshon shumë nga ai i mjedisit të jashtëm, përbërja e të cilit është e njohur: 78% azot, 21% oksigjen dhe 0,035% dioksid karboni. Se në cilën masë ajri në stallë do të jetë i ngjashëm me mjedisin e jashtëm varet nga shumë faktorë: ngrohja dhe emisioni i gazrave të ndryshëm që i prodhojnë kafshët, konstruksioni i stallës, sistemet e ventilimit dhe temperaturës së jashtme. Përqendrimi i madh i gazrave të dëmshëm siç janë: **amoniaku, dioksidi i karbonit, monoksidi i karbonit, metani, sulfati hidrogjen, pluhuri organik** e të tjerë, kanë ndikim negativ mbi shëndetin e kafshëve shtëpiake. Ata e zvogëlojnë produktivitetin e kafshëve, kurse përqendrimi tepër i madh i sulfetit të hidrogjenit mund të jetë vdekjeprurës.

Amoniaku është gaz pa ngjyrë me aromë të fortë, i cili formohet në mënyrë natyrore nga shkatërrimi i materieve të pasura me azot. Në stalla në pjesën më të madhe kryhet nga plehu. Avullimi i amoniakut në stalla varet nga: vlera PH e plehut, nga temperatura, shpejtësia e lëvizjes së ajrit dhe përqendrimi i amoniakut tek plehu. Amoniaku është më i lehtë se ajri, prandaj gjendet në pjesën e sipërme të stallës. Ai ka aromë të fortë, shkrihet në avull me ujë, e dëmton mukozën dhe gjatë ndikimit më të gjatë shkakton sëmundje në rrugët e frymëmarrjes sidomos tek kafshët e reja. Që të zvogëlohet sasia e amoniakut në stalla, është e nevojshme që të hiqet plehu i lëngshëm dhe i fortë, të sigurohet ventilim i mirë në stallë, sidomos në verë.

Metani dhe dioksidi i karbonit janë

gazra pa ngjyrë dhe aromë. Janë më të rënda se ajri dhe gjenden më tepër në shtresat e poshtme. Përqendrimi i zmadhuar i këtyre gazrave çon në konsumim të dobët të ushqimit, pasivitet tel kafshët. Përqendrimet më të mëdha shkaktojnë vështirësi gjatë frymëmarrjes, kurse nëse janë nën ndikim të tyre për një kohë të gjatë shkaktohet dhe mbytje dhe helmim i kafshëve. Këto gazra mund të shkaktojnë probleme shëndetësore tek punëtorët të cilët qëndrojnë një kohë më të gjatë në stallë.


Monoksid karboni është gaz pa ngjyrë dhe aromë i cili në mushkëri lidhet me hemoglobininë, e ndalon lidhjen e oksigjenit dhe shkakton asfiksi. Shfaqet në objekte për shpendë dhe derra nëse në dimër ngrohen me lëndë djegëse të fortë, kurse ajrosja nuk është si duhet.



Sulfiti i hidrogjenit është gaz pa ngjyrë me aromë të fortë jo të këndshme. Shfaqet si rezultat i shpërbërjes së sulfiteve të substancave joorganike nga bakteret pa prani të ajrit. Ai është gaz i cili shfaqet në pellgje uji dhe kanalizime. Sulfiti i hidrogjenit është gaz shumë helmues dhe i ndezshëm, është më i rëndë se ajri dhe mblidhet gjithmonë në fund të hapësirave të pa ajrosura.

Pluhuri gjendet gjithmonë në ajër. E ka prejardhjen nga ushqimi, shtresa, myqeve, polenit dhe parazitëve. Ai qëndron pezull në ajër dhe mund të jetë mbartës i mikroorganizmave patogjene. Ndikon negativisht mbi shëndetin e njerëzve dhe kafshëve.

Vlerësimi i cilësisë dhe përbërjes së ajrit, më lehtë ndiqet nga sjellja e kafshëve, sidomos e lopëve. Tek sistemi i lidhur për ruajtje, nëse ajri



nuk është i mirë, lopët janë të shqetësuara, shtrihen dhe ngrihen shpesh. Përbërja më e keqe e ajrit është në fund të sipërfaqe së stallës, kurse më i mirë është në lartësi sa një kokë njeriu.

Mënyra më e mirë që të rregullohet niveli i gazrave të dëmshme në stalla është vendosja e ventilimit të mirë i cili do të sigurojë qarkullim të ajrit. Kështu rregullohen parametrat e rëndësishëm, siç janë: përmbajtja e oksigjenit, temperatura dhe lagështia e ajrit dhe përqendrimi i gazrave të dëmshme. Që të jenë të shëndetshme dhe produktive, kafshët duhet të kenë ajër të pastër të mjaftueshëm të pasur me oksigjen. ●

Të ushqyerit të bletëve në periudhën e dimrit dhe pranverës së hershme

Rezultatet krahasuese nga hulumtimi i zbatuar në Shqipëri për atë se cili lloj ushqimi për bletët, d.m.th. çfarë përbërje e bukës së bletëve është më ushqyese për bletët në periudhën e dimrit dhe pranverës së hershme para fillimit të ushqimit kryesor në natyrë.

Shkruan: dr. Vitor Malutaj

Bletët, sikurse të gjitha kafshët e tjera, kanë nevojat e tyre unike për ushqim si proteina, karbohidrate, yndyra (lipide), vitamina e lëndë minerale. Ushqimi natyral për bletët është nektari dhe poleni. Nektarin bletët e përdorin për të prodhuar mjaltin, i cili u jep atyre energjinë e nevojshme për të fluturuar dhe për të përballuar gjithë aktivitetet e tjera fizike. Pjesën tjetër të vlerave ushqyese e jep poleni. Mungesa, pakësimi apo poleni i varfër redukton në mënyrë të ndjeshme aktivitetin e bletëve.

Bletërritësit, zakonisht i ushqejnë bletët me shurup sheqeri në fillim të pranverës, pas prodhimit të mjaltit, ose gjatë mungesës së polenit, për t'i inkurajuar bletët të punojnë, por shurupi i sheqerit është veçse karbohidrat, që u jep energji bletëve të dobëta, por nuk përmban proteina dhe vlera të tjera ushqimore të kërkuara për rritjen e bletëve të reja dhe për prodhimin e qumështit të bletës. Për këtë arsye, edhe në vendin tonë, po përdoret gjithnjë e më shumë bukë blete, e cila përmban sipas markave të prodhimit përveç karbohidrateve edhe polen apo burime proteinash për të zëvendësuar polenin natyral. Një nga këta ushqime shtesë për bletët është edhe Feedbee.

Çfarë është Feedbee ?

Feedbee është një dietë e re ushqimore me origjinë bimore që zëvendëson polenin në mënyrë të balancuar dhe që dallohet nga substanca 100 % natyrale me bazë bimore, pa përmbajtje poleni, pa produkte shtazore, pa soje, pa ngjyues artificial, pa substanca konservuese, pa aroma artificiale dhe nuk përmban materiale gjenetike të modifikuara.

Eksperimenti u ngrit për të parë efektin e të ushqyerit të bletëve gjatë periudhës së pranverës së hershme si dhe për të bërë diferencën midis të ushqyerit me feedbee dhe bukë të zakonshme nëse do të ketë.

Materiale dhe metoda:

Eksperimenti u krye në dy parqe bletësh, njëri në Qinam të Tiranës dhe tjetri në fshatin Dedaj të Rrethit të Pukës.

Eksperimenti filloi me 14.1.2015. Nga 64 familje të kontrolluara u zgjodhën 40 familje që kishin afërsisht të njëjtin numër rrugë mizash dhe të njëjtin numër kornizash me pjellje. Duhet theksuar se kornizat me pjellje në të gjitha familjet e bletëve nuk ishin të mbushura, por vetëm kishte larva (të vulosura ose jo) në madhësinë e një pëllëmbë dore.

Të 40 familjet e futura në eksperiment u ndanë në 4 grupe, u shënuan me inicialet përkatëse F1, F2, F3, F4, F5, F6, F7, F8, F9 dhe F10 për familjet që do të ushqeheshin me feedbee 10 % dhe X1, X2, X3, X4, X5, X6, X7, X8, X9, dhe X10 për familjet e ushqyera me bukë 0 të blera nga një kompani, emri i të cilës është konfidencial dhe Y1, Y2, Y3, Y4, Y5, Y6, Y7, Y8, Y9 dhe Y10 të ushqyera me bukë 0, të blera nga një kompani tjetër, gjithashtu me emër konfidencial. Grupi i kontrollit që nuk u ushqye gjatë gjithë periudhës së eksperimentit u shënuan me inicialet K1, K2, K3, K4, K5, K6, K7, K8, K9 dhe K10.



Secilës familje nga 3 grupet e para iu vendos përkatësisht nga një bukë re-spektive, ndërsa grupit të kontrollit nuk i është vendosur bukë asnjëherë dhe nuk është ushqyer me asnjë lloj ushqimi gjatë gjithë periudhës.

Të ushqyerit e 3 grupeve të para me bukë është bërë me 14 janar për herë të parë, me 14 shkurt për herë të dytë (pasi nga kontrolli rezultonte se në këtë periudhë nuk e kishin konsumuar bukën e parë), me 1 mars për herë të tretë, me 14 mars për herë të katërt dhe me 29 mars për herë të pestë dhe të fundit. Pas kësaj date nuk është bërë më ushqyerje e bletëve, pasi kishte ushqim të mjaftueshëm në natyrë.

Rezultatet dhe diskutimi:

Që në konsumimin e bukës së parë, e cila përfundoi për një afat kohor 1 muaj filloj të vërehej efekti i të ushqyerit. Kështu, Grupi "F", prej 10 familje bletësh të ushqyera me feed-bee 10 %, pas konsumimit të 1 buke (1 kg) për familje me datën 14 shkurt 2015 kishte rritur numrin e rrugëve të mizave me 8 rrugë në total. Grupi "X", i ushqyer me buke 0 të kompanisë X kishte të njëjtën rrugë mizash. Grupi "Y", i ushqyer me buke 0 të kompanisë Y kishte 1 rrugë më pak dhe Grupi i kontrollit kishte 1 rrugë më shumë.

Ndikim të dukshëm pati në muajin e parë të të ushqyerit në stimulimin e pjelljeve. Kështu Grupi "F", nga 20 korniza me pjellë me 14 janar shkoi në 41 korniza me 14 shkurt ose 205 %, Grupi "X", nga 20 korniza shkoi në 35 korniza ose 175 %, Grupi "Y" nga 20 korniza shkoi në 31 korniza ose 155 %, ndërsa Grupi i Kontrollit "K"

nga 20 korniza shkoi në 25 korniza ose 125 %.

Pothuajse ky ritëm rritjeje u ruajt edhe në periudhën në vazhdim, por meqenëse në këtë periudhë është rritur si numri i bletëve dhe i pjellës në secilin zgjua të çdo grupi, konsumi i bukës është bërë më shpejt, kështu që edhe kontrolli dhe vendosja e bukës tjetër është bërë afërsisht çdo 15 ditë, kur e kishin konsumuar të gjitha familjet e marra në eksperiment, pavarësisht se ndonjë grup e konsumonte atë më parë. Në total u përdoren 5 bukë për çdo familje blete të tre grupeve të para, ndërsa për grupin e kontrollit siç u tha edhe më sipër nuk është përdorur fare ushqim. Të ushqyerit me bukë është ndërprerë pas 29 marsit, kur u vlerësua se ka ushqim të mjaftueshëm në natyrë.

Duhet theksuar se me 15 prill 2015 në të gjitha zgjojet e të 4 grupeve u vendosen diafragma, jo vetëm për të ndaluar pjelljen në katin e dytë, por edhe për t'i detyruar në një farë mënyre për të prodhuar mjaltë.

Rezultatet e katër grupeve nga 24 maji 2015 janë si vijon:

1 – Numri i rrugëve me mizë: Grupi "F" kishte gjithsej 183 rrugë mize ose mesatarisht 18.3 rrugë mize për zgjua. Grupi "X" kishte 168 rrugë mize ose 16.8 rrugë për zgjua ose 91 % të grupit "F", Grupi "Y" kishte 153 rrugë mize ose 15.3 rrugë për zgjua ose 84 % të grupit "F" dhe Grupi i Kontrollit "K" kishte vetëm 137 rrugë mize ose 13.7 rrugë për zgjua ose 75 % të Grupit "F".

2 – Numri i kornizave me pjellë: Duhet theksuar se këtu nuk mund të nxirret ndonjë konkluzion i saktë, sepse janë vendosur diafragmat me 15 prill, por ajo që u vërejt edhe në këto kushte është se në grupin "F" (të ushqyer me feedbee) në ditën e vjeljes së mjaltit me 24 maj 2015 të 10 kornizat e katit të parë të çdo zgjoj të këtij grupi kishte pjellje, pra në 100 korniza, ndërsa në grupin "X"- 87 korniza; në grupin "Y" kishte 80 korniza dhe në Grupin e Kontrollit kishte vetëm 72 korniza me pjellë.

3 - Prodhimi i Mjaltit: Në Grupin "F" u morën 158 kg mjaltë ose 15.8 kg për zgjua. Në grupin "X" u morën 135 kg mjaltë ose 13.5 kg/zgjua ose 85 % e Grupit "F". Në Grupin "Y" u morën 124 kg mjaltë ose 78 % e Grupit "F" dhe në Grupin e Kontrollit u morën 82 kg mjaltë ose 52 % e prodhimit të Grupit "F".



Konkluzione dhe rekomandime:

A – Konkluzione:

1. Të ushqyerit e bletëve me bukë blete në periudhën e dimrit dhe të pranverës së hershme ose më saktë që nga fillimi i pjelljes në zgjua e deri në fillimin e sekretimit të nektarit të mjaftueshëm në natyrë, nuk ndikon në cilësinë e mjaltit, pasi e gjithë sasia konsumohet nga vetë bletët dhe nuk depozitohet në zgjua, pasi në këtë periudhë bletët kanë nevojë për ushqim dhe nuk gjejnë nektar në natyrë.

2. Të ushqyerit e bletëve me bukë blete në periudhën e dimrit dhe të pranverës së hershme ndikon pozitivisht në zhvillimin e familjeve të bletëve, duke rritur numrin e bletëve të fushës në sezonin e sekretimit të nektarit në natyrë.

3. Të ushqyerit e bletëve me bukë blete në periudhën e përmendur më lart ndikon dukshëm në prodhimin e mjaltit, duke u shpërblyer çdo bukë e përdorur me 1-1.5 kg mjaltë, ose 5-7 herë të vlerës së bukës së përdorur.

4. Përdorimi i bukës së bletës me përmbajtje 10 % feedbee jep rezultate rreth 15-22 % më të larta se përdorimi i llojeve të tjera të bukës dhe dyfishin e prodhimit të mjaltit më shumë se në bletët kur nuk përdoret të ushqyerit me bukë blete.

B – Rekomandime:

1. Mbështetur në rezultatet e studimit (eksperimentit) të mësipërm rekomandoj të ushqyerit e bletëve me bukë blete për periudhën e dimrit dhe të pranverës së hershme ose më saktë sipas zonave të vendit tonë nga fillimi i pjelljes në zgjua deri në sekretimin e mjaftueshëm të nektarit në natyrë, në sasi aq sa marrin vetë bletët për çdo zgjua sipas forcës që kanë.

2. Mes bukëve që mund të përdoren rekomandoj përdorimin e bukës me përmbajtje feedbee 10 %, e cila ka rezultuar me rezultatet më të larta si në zhvillimin e bletëve dhe prodhimin e mjaltit.

Tiranë, maj 2015.





API-lift - vinç universal për bletët

Shkruan: Bllagojçe Najdovski

Bletaria është degë intensive pune në bujqësi, ku në varësi nga lloji i kosheres dhe pesha e hojeve (sidomos nëse janë plot me mjaltë) të cilat bletërritësi duhet t'i ngrejë, peshojnë nga 20 deri në 50 kg. Kjo vlen sidomos nëse keni një numër më të madh kosheres prej të cilave çdo koshere ka nga disa korniza, por këtu futen edhe manipulimet e shumta gjatë vitit.

Puna fizike është e nevojshme gjatë pastrimit më të thjeshtë të dyshemesë në fillim të sezonit të bletarisë, në pranverën e hershme, pas nxjerrjes së mjaltit, kur hojet e mbushura me korniza duhet të çohen për centrifugim. Zgjidhje për këtë problem kanë gjetur disa bletërritës inventivë, ata të ish republikave sovjetike, të cilët në bazë të parimit bëj vetë kanë bërë shumë variante të vinçave të lëvizshëm për bletari, me dhe pa forcë vetjake, që ka qenë nxitje edhe kompani më serioze të bëjnë dizajnet personale. Kështu, në Kongresin Botëror të Bletërritësve "Apimondia 2009" është dhënë çmim për shpikjen multifunksionale vinçin "Api-lift". Bëhet fjalë për një makineri shumë të thjeshtë, që vihet në lëvizje nga bormakineri akumuluese elektrike me bateri litiumi prej 18 volti, të cilat mund t'i përdorni gjysmë ore, kohë që është e mjaftueshme për një park më të vogël bletësh.

API-lift përdoret për shumë aktivitete në bletari, si për transportin e mjaltit për centrifugim, për ngritje dhe ngarkim në rimorkio të kosheres së bletës gjatë transferimit të bletëve. Në varësi nga prodhuesi vinçi mund të ngrejë një koshere të tërë blete në lartësi edhe mbi 1,6 metra që e zgjidh problemin për ngarkim të koshereve të bletëve në kamion me dysheme më të lartë.



Bletaria kërkon punë fizike, kurse si lehtësim mund të përdoret ky vinç i cili përdoret për shumë aktivitete në bletari, si për transportin e mjaltit për centrifugim, për ngritje dhe ngarkim në rimorkio të kosheres së bletës gjatë transferimit të bletëve.



Gjithashtu mund të përdoret edhe për transportin e peshave më të rënda në parkun e bletëve edhe mbi 100 kilogram. Bletërritësi inventivë kanë ndërtuar modele të cilat punojnë edhe me motorë me benzinë që janë ideale për transport të koshereve në terrere jo të rrafshëta. E gjithë filozofia është te korniza e vinçit të dizajnohet menegene e cila do ta mbajë kosheren, por do të jetë edhe e lëvizshme. Çmimi i



modeleve komerciale të API-lift, në varësi nga fakti se cilat të dhëna i kanë, është mbi 500 euro, por nëse e bëni te ustai mund t'u kushtojë dy herë më pak, kurse për shkak të ndërtimit të thjeshtë mund të bëhet edhe në bazë të parimit "bëj vetë". ●

Ekonomik dhe i përshtatshëm për bujqit individualë

Shkruan: Nikolla Stanishev

Në këtë tekst do të desha të jap një pasqyrë për traktorin e markës NEW HOLLAND, modeli TT 45 me fuqi prej 45 KF, i cili prodhohet në dy variante, varianti 2WD me fuqi lëvizëse në rrotat e pasme, si dhe 4WD me fuqi në të gjitha rrotat (e para tërheq).

Siç është vënë në titull, ky është një traktor ekonomik për bujqit individualë sepse motori i tij dinamik me tricilindra ju jep mundësi ta përdorni me makineri të ndryshme shoqëruese për përfundim më të shpejtë dhe më ekonomik të të gjitha punëve në fushat tuaja.

Me çmimin që ofrohet mundësohet secili të mund të ketë në oborrin e vet një traktor të një prej brendeve më të njohura dhe të dëshmuara.



Përveç forcës prej 47 KF që dëshmohen si edhe më të fuqishëm në versionin 4WD, ky traktor mund të lëvdohet edhe me fraksionin e dyfishtë, me të cilin ofron funksion të kardanit pavarësisht nga lëvizja e traktorit. Hidraulika e pasme ka fuqi të ngrejë prej 1500 kg, e pajisur me dalje hidraulike për përdorim të jashtëm me funksion të dyfishtë, si edhe me Sistemin Lift - 0 - Matic me të cilin arrihet përdorim i lehtë me hidraulikë (ngritje dhe ulje e shpejtë) pa ndikuar mbi performancat e tjera për thellësi dhe trysni.●

TRAKTOR i fuqishëm dhe i qëndrueshëm



Shkruan: Sashko Stoshij

Hattat 240 S është model i traktorit të njohur për cilësinë dhe qëndrueshmërinë e vet. Ai është traktor universal me fuqi me dy rrota dhe i plotëson nevojat për të gjitha punët bujqësore, komunale dhe transport. E vë në lëvizje motori më i mirë, më i fuqishëm dhe më i njohur anglez, Perkins, me tri cilindra me 50 kuaj fuqi dhe EURO3 standarde dhe shpenzim minimal në kryerjen e të gjitha nevojave të bujkut. Transmisioni është i sinkronizuar me marsh 8+2. Largësia e madhe midis boshteve prej 1900mm, pesha e tij prej 2050 kilogram, pesha e parme dhe pesha e pasme kontribuojnë për një stabilitet edhe më të madh. Kjo e bën të jetë traktori më i fuqishëm në klasën e vet. Timoni hidraulik mundëson kontroll më të lehtë dhe më të saktë për punë edhe në kushtet më të vështira. Të dy setet e daljeve hidraulike dhe kapaciteti maksimal i ngritjes së hidraulikës deri në 1650 kilogramë e veçojnë nga traktorët e tjerë të të njëjtës klasë. Ka dy opsione: modeli për pemëtari dhe vreshtari dhe modeli për bujqësi.

HATTAT 240 S I KA KËTO KARAKTERISTIKA:

Forca: 2 wd;

Lloji i motorit: 1103D-33;

Fuqia: 36,9 kW; 50 KF;

Vëllimi i motorit: 3300 cm³;

Numri i cilindrave: 3;

Numri i rrotullimeve: 22.000/min;

Kapaciteti i rezervuarit: 50 litra.

Transmisioni:

Lloji – konstant mekanik;

8 shpejtësi para;

2 shpejtësi pas.

Boshti shoqërues:

Lloji – me një shpejtësi;

Numri i rrotullimeve: 5.400/min;

Numri i dhëmbëve: 6.

Frenat:

Freni kryesor – disqe të lyera me graso;

Frena për parkim – e pavarur;

Sistemi për frenim hidraulik.

Menaxhimi:

Lloji – hidraulik;

Hidraulika – pozicionim automatik

dhe kontroll të ngritjes;

Numri i mjeteve shtesë: 4;

Kapaciteti i ngritjes së hidraulikës:

1.650 kg.

Dimensione dhe pesha:

Largësi midis boshteve: 1.900 mm;

Gjatësia: 3.550 mm;

Gjerësia: 1.680 mm;

Pesha: 2.200 kg.

Kabina:

Kabina kompatible;

Izolim i tërësishëm;

Me ngrohje dhe ftohje;

Me drita të pasme dhe të përparme për punë.



Shkruan: Nenad Stepaniq

Massey Ferguson MF 5610 Antartctica 2 është traktor universal për ferma bujqësore, blegtores dhe të përziera me motor AGCO Power prej 105 kuajsh fuqi, si dhe me menaxhim jashtëzakonisht të thjeshtë në kombinim me marsh Dyna-4 me efikasitet të lartë.



Në Polin e Jugut me traktor

Holandezja Manon Osevert është e para që ka arritur në pikën më jugore të Tokës me traktor. Pas 17 ditësh udhëtim nëpër Antarktik, arriti në Polin e Jugut. Në dhjetor të vitit 2014, Massey Ferguson MF 5610 ka shkruar historinë. Rruga e ekspeditës "ANTARKTIK 2" ka qenë nga Holanda nëpër Evropë dhe Afrikë. Është udhëtuar në Antarktik 2.500 kilometra natë e ditë, me qëndrime gjatë rrugës për ndryshim të shoferëve të traktorit dhe mirëmbajtjen e traktorit që të arrijnë deri në pikën më jugore të botës. Ekipi është ballafaquar me kushtet e ashpër kohore në temperaturë e cila ka vajtur edhe deri në minus 56 gradë celsius.

Në Antarktik me teknologji të dëshmuar, prodhimi i kufizuar special i traktorit të njohur universal MF 5610, Manon Osevert ka shfaqur nderin për ekspeditën mbresëlënëse "Antarktik 2" me traktorin MF 5610 në Polin e Jugut, e cila është ndjekur nga miliona njerëz. Gjatë kësaj, ajo ka kaluar nëpër hapat e sër Edmund Hilarij, i cili në vitin 1958 e ka

kryer ekspeditën e parë të motorizuar në Polin e Jugut me ndihmë të Ferguson TE 20.

Në vetitë dhe karakteristikat tipike të MF 5610 të ekspeditës Antarktik 2 futen: fuqia pa kompromis, siguria e punës dhe stabiliteti. Pikërisht këto karakteristika që kërkohen në mënyrë të njëtrajtshme edhe në Antarktik edhe në të gjitha fermat nëpër botë, me motorin e vet AGCO Power prej 105 kuaj fuqi, me koncept karakteristik të pamjes së hapur, si edhe menaxhim të thjeshtë të jashtëzakonshëm në kombinim me marshin me efikasitet të lartë Dyna-4, MF 5610 është traktor i përkryer ngarkues dhe universal për ferma bujqësore, blegtores dhe të përziera.

Ky traktor është tërësisht i pavarur posedon karakteristika të cilat janë të përshtatshme për udhëtime të gjata prej 5.000 km nëpër rajone nga më të vështirat dhe jomikpritëse në botë. Prodhimi special i MF 5610 Antarktik 2 është i kufizuar nga numri dhe për shittje të mëtejshme me siguri do të ketë interesim të ngjashëm si edhe për modelin e tij. ■

Veti karakteristike të prodhimit special të MF 5610 Antarktik 2:



- Marsh Dyna-4 me sistem AutoDrive;
- "SuperDeluxe" ulëse për shoferin me suspenzion me ajër;
- Heqje mekanike e kabinës;
- Pako me drita pune me 6 LED llamba;
- 540/540E/1000 bosht;
- Massey Ferguson Premium Off-Road Audio Entertainment System;
- Pastrues për xhamin prapa;
- Ngjyrë speciale;
- Përgatitje për sistem telemetrik Ag Command;
- Pllakë speciale Antarktik2/Drivers Kit;
- Goma teleborg si standar;
- Pajisje për ajër të kondicionuar.



MF 3600 VSF



MF 3600 A



MF 5600



MF 6600



MF 7600



MF 8600

MASSEY FERGUSON **PRODHUESI MË I MADH** **BOTËROR I TRAKTORËVE**

▼
Paleta e traktorëve
nga 20 -400 KF

▼
Paleta e kombajnave
nga 176 – 500 KF

▼
250.000
traktorë në vit

▼
Kombajna e parë
vetëpunuese në treg

Massey Ferguson distributorë nën:
www.austrodiesel.at
TEL. 00 385 99 22 98 415

Massey Ferguson është brend i njohur botëror i koncernit AGCO

E RE

AUSTRO DIESEL SI
IMPORTUES I PËRGJITHSHËM

▼
MASSEY FERGUSON DHE AUSTRO DIESEL
32 vjet bashkëpunim të suksesshëm

▼
Përgjegjës për 10 shtet nga Evropa Qendrore (Austria,
Çekia, Sllovakia, Hungaria, Sllovenia, Kroacia, Serbia,
Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, Mali i Zi)

▼
50.000 MF traktorë të servisuar
2.000 MF kombajna të servisuara

▼
Kompetenca më e madhe për pjesë rezervë

Austro Diesel

 **AGCO**
Your Agriculture Company


MASSEY FERGUSON



Bashkimi i GRAVE FERMERË

DITA E MJALTIT PUKJAN DHE TRYEZË E RRUMBULLAKËT PËR BLETARINË

Gruaja fermere është një nga subjektet më të rëndësishme për zhvillimin e bujqësisë, por në Maqedoni dhe në rajon ato ende janë pjesë e grupeve të marginalizuara, sepse shumë pak janë përfshirë në shoqata bujqësore dhe në politikën bujqësor. Për këtë qëllim Federata e Fermerëve e formoi Rrjetën e Grave Fermere që ta involvojë gruan rurale në zhvillimin e bujqësisë. Një pjesë e madhe e grave janë bërë biznesmenë, d.m.th. gra biznesmenë dhe lideri nëpërmjet FFRM-së. Një prej tyre është edhe Ljubica Xoniq e cila në 2 hektarë tokë prodhon brokullë në fshatin Čerņičani, Dojran dhe tani është koordinatore e Rrjetës së Grave Fermere në FFRM. Ajo thotë "Për zhvillimin e biznesit tim kam mësuar nga përvoja personale, nga puna ime, nga pjesëmarrja nëpër trajnime, seminare, konferenca, vizita studimore, anëtarësimi në Federatën e Fermerëve ku kam marrë informacione me karakter edukativ dhe e gjithë kjo më ka ndihmuar ta zhvilloj biznesin tim dhe ekzistencën time. Lirisht mund të them se unë si menaxhere dhe grua lider dhe biznesi im jemi produkt i aktiviteteve dhe angazhimit në FFRM". Këtë vit FFRM-ja për herë të parë ka realizuar takime me gratë fermere të rajoneve të ndryshme të shtetit me qëllim që ta rritë interesin e tyre dhe anëtarësimin në shoqatat bujqësore. Takimet janë realizuar në Mustafino, Bosillovë, Gjevgjeli, Pehëevë, Negotinë, Mogillë dhe Shkup, ku kanë marrë pjesë 103 përfaqësues. Aktivitetet janë pjesë e projektit "Zhvillimi Institucional i FFRM-së" të cilin Federata e zbaton me organizatën suedeze WE Effect. ●

Është bërë traditë tashmë në rrethin e Pukës që e shtuna e dytë e muajit korrik të festohet si "Dita e Mjaltit Pukjan". Në vigjilje të kësaj dite, Shoqata "AGROPUKA" organizoi me 11 korrik Panairin e Mjaltit dhe Tryezën e Rrumbullakët për bletarinë. Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës "AGROPUKA" z. Sabah DJALOSHI, duke ju uruar mirëseardhjen ekspozuesve dhe vizitorëve në këtë panair e deklaroi atë të hapur. Kryetari i sapozgjedhur i Bashkisë Pukë z. Gjon Gjonaj u shpreh se zhvillimi i bletarisë do të jetë një nga prioritetet kryesore, ndërsa Drejtoresha e Shkollës së mesme, Angelina Meta (Paloka) tha se po rritet numri i të rinjve që po merren me bletari.

Në Tryezën e Rrumbullakët për bletarinë, bletaret sollën shqetësimet e tyre si mungesa e subvencionimit nga shteti, mungesa e infrastrukturës për shtegtim, mos trajtimi njëkohshëm për sëmundjet e varoatozës dhe nozematozës, etj. Drejtori i IKC Kosovë z. Ekrem Bajrami solli në këtë Tryezë eksperiencën e Kosovës në bashkëpunimin e shoqërisë civile me pushtetin lokal, ndërsa botuesi gazetës Bletaria Shkodrane dhe i disa librave për bletarinë, Ilir Bala u ndal në problemet e sigurisë ushqimore. Në fund të kësaj dite u shpallën edhe fituesit e çmimeve për mjaltin më të mirë. Shoqata "AGROPUKA" iu dha fituesve nga 50 copë kavanoza qelqi për punë.



KRIJIMI I TË ARDHURAVE PËR MË PAK SE 0,9 EURO TË ARDHURA FAMILJARE – RRËFIMI I URIM ILJAZIT NGA FSHATI GJURKOVÇ, KOMUNA SHTIME

Bashkësia RAE është midis bashkësive të cilat ballafaqohen me normën më të madhe të papunësisë. Të rinjtë nga mosha 7 vjet e lart nuk i kanë të njëjtat të drejta si shokët e tyre të bashkësive të tjera, siç janë arsimi përkatës dhe mundësia për punësim. Rrëfimi i Urim Iljazit dhe familjes së tij tregon se si IKC dhe WE EFFECT ua kanë ndryshuar jetën 9 anëtarëve të kësaj familjeje. Familja e cila përbëhet nga 9 anëtarë duhej të jetonte me kompensim të siguruar nga shitja e shisheve plastike dhe kanoçeve. IKC së pari i vlerësoi nevojat e familjes.

Pas vlerësimit të opsioneve për ulje të varfërisë në këtë familje të madhe nga RAE, resurset janë drejtuar kah kultivimin të luleshtrydheve. Përgatitja e tyre për kultivim të luleshtrydheve ishte pranuar pozitivisht. Këto rezultate i mësuam nga biseda me Urim Iljazin, një djalosh i ri në moshë 11 vjeçare, i cili e ka marrë përgjegjësinë ta ndihmojë familjen e vet në kultivimin dhe kujdesin për luleshtrydhet, si mundësi për tejkalimin e varfërisë. Urimi dhe familja e tij i shprehën perceptimet dhe përvojat e tyre në këtë projekt.

“Nëpër shumë vite preokupimi kryesor i familjes sonë ishte siguri i ushqimit për familjen tonë prej 9 personash. Ne asnjëherë nuk kemi pasur mundësi të arsimohemi, për shkak të resurseve të kufizuara financiare. Pasi jemi financuar nga projekti për kultivim të luleshtrydheve, ne kishim mundësi të shisnim prodhime në tregun lokal, me një prodhimtar prej 2.000 eurosh. Ne jemi shumë të kënaqur se më në fund familja jonë e tejkaloi preokupimin kryesor, prandaj do të bëjmë përpjekje të mëtejshme që të kemi më tepër sukses.”



FERMERËT E RINJ NDËRTOJNË PJESËMARRJE AKTIVE NË PUNËT E BUJQËSISË

Duke e parë situatën këto vitet e fundit, se interesi dhe pjesëmarrja në punët e bujqësisë dhe aktivitetet e bujqësisë të të rinjve të cilët jetojnë në fshatra, është në nivel të ulët dhe ka angazhim minimal nga ana e tyre, Fondacioni AgriNet Shqipëria me mbështetjen e We Effect, ka përfshirë disa aktivitete në programin e vet me fermerët e rinj që të ngjallin interes dhe pjesëmarrje aktive në punën e fermës. Për këtë qëllim në fillim të korrikut AgriNet Shqipëria me disa anëtarë, fermerë të rinj prej asociacioneve për zhvillim të frutave në rajonin e Korçës, organizuan vizitë për shkëmbim të përvojave në rajonin e Edesës, Greqi. Kjo vizitë krijoi mundësi

që pjesëmarrësit të shikojnë disa ferma për prodhim të frutave (molle, qershi) të cilat kanë zbatuar teknologji bashkëkohore për kultivim si edhe për mbrojtje të tyre prej faktorëve të natyrës (breshër). Me qëllim që bujqit e rinj ta dallojnë organizimin e bujqve jashtë territorit të Shqipërisë në shoqata dhe kooperativa për prodhim, mbledhje dhe shitje të prodhimeve, vizita është bërë në një frigorifer për mbledhje të prodhimeve bujqësore në pronësi të një kooperative bujqësore në atë rajon. Kjo vizitë është vlerësuar pozitivisht nga fermerët e rinj dhe është zmadhuar interesi për implementim të teknologjive të reja në fermat e tyre.





FFRM



FFRM-ja i organizon dhe bashkon fermerët në nivel nacional, me qëllim të përbashkët që të zgjidhen problemet dhe të përmirësohet prodhimtaria në bujqësi dhe zhvillimi rural në Republikën e Maqedonisë. Qëllimi kryesor është të jetë organizatë moderne, transparente dhe demokratike e fermerëve e cila është e njohur në nivel nacional dhe i njeh dhe bashkon pjesën më të madhe të bujqve, i përfaqëson dhe i mbrojnë interesat e tyre dhe vepron në drejtim të përmirësimit dhe zhvillimit të prodhimit bujqësor dhe rajonet rurale në përputhje me nevojat reale të bujqve në Republikën e Maqedonisë. FFRM-ja vepron në nivel nacional, në përputhje me nevojat dhe nevojat e anëtarëve të vetë. Si model i strukturuar hapëron sipas gjurmëve të bujqve suedezë me nënshkrim të marrëveshjes për bashkëpunim me Federatën Suedeze të Fermerëve. Mbi 10.000 njerëz janë përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte të përfshira në organizatë, domethënë: si anëtarë të organeve të menaxhimit, të punësuarit, vullnetarët, pjesëmarrësit në trajnime për punëtori edukuese, pjesëmarrësit në udhëtimet studimore jashtë shtetit,

në organizimin e panairëve dhe shumë formave të tjera. Përveç kësaj, realizohet bashkëpunim intensiv me organizata nga rajoni, siç janë Shqipëria, Bullgaria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Serbia, Rumania, Sllovenia si dhe me organizata nga shtetet evropiane siç janë Suedia, Franca dhe Holanda. Një prej mjeteve më efikase të FFRM-së për informim dhe edukim është revista e saj mujore "Toka ime" e cila është e vetmja revistë mujore në Republikën e Maqedonisë e cila jep komentet dhe mendimet e bujqve, ekspertëve dhe institucioneve relevante, raporte, këshilla edukuese dhe analiza. Në drejtim të zhvillimit të fermerëve të vegjël, bashkëpunimit rajonal dhe kooperativave, FFRM-ja filloi me realizimin e projektit "Zhvillimi institucional i FFRM-së" i cili realizohet në bashkëpunim me organizatën suedeze We Effect.

AGROPUKA



AGROPUKA është një shoqatë e prodhuesve bujqësorë dhe blegtoralë të rrethit të Pukës (Shqipëria e Veriut). Ajo është krijuar në 2001 me mbështetjen e Bashkëpunimit për Zhvillim të Zvicrës (SDC). Që nga ajo kohë, shoqata ka rritur anëtarësinë e saj dhe ka zgjeruar aktivitetin dhe shërbimet, për të plotësuar nevojat e anëtarëve dhe komunitetit në përgjithësi.

Shoqata kontribuon në zhvillimin e integruar rural nëpërmjet inkurajimit dhe promovimit të zhvillimit ekonomik si dhe të iniciativave dhe veprimtarive për të përmirësuar jetesën e anëtarëve të AP dhe komuniteteve që jetojnë në zonat rurale. Në këtë mënyrë AP ndikon në reduktimin e varfërisë dhe pa-drejhtësive sociale në zonat rurale.

Nga viti 2011, Agropuka po zbaton projektin "Të kontribujmë në përmirësimin e qëndrueshëm të jetës së banorëve të zonave rurale të Pukës" që financohet nga We Effect (Suedi).

Projekti është në fazën e dytë të tij (2014-2016; faza e parë u zbatua gjatë 2011-2013) dhe

synon përmirësimin e qëndrueshëm të jetesës në zonat rurale nëpërmjet rritjes së të ardhurave të fermerëve të vegjël dhe promovimit të demokracisë dhe pjesëmarrjes lokale.

Në tre vitet e ardhshme shoqata do të përqendrohet në tre fusha: (1) Përmirësimin e kushteve të jetesës së anëtarëve të AP dhe të komuniteteve në zonat ku punon AP nëpërmjet promovimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të prodhimit, marketingut, dhe modeleve të kooperimit; (2) Promovimin e mbrojtjes dhe zhvillimit të mjedisit; dhe (3) Promovimin e demokracisë lokale dhe përfshirjes sociale të komuniteteve rurale në vendim-marrjen lokale. Për këtë Agropuka do të rrisë qëndrueshmërinë, përgjegjësinë dhe kapacitetin organizativ të saj.

INITIATIVE FOR KOSOVA COMMUNITY-IKC



IKC, Initiative for Kosova Community është themeluar në vitin 2005 si një prej organizatave lokale joqeveritare në Kosovë. Ajo është formuar si spin-off organizatë e organizatës joqeveritare belgiane Balkanactie vzw. Ajo është themeluar nga personeli lokal i Balkanactie vzw. Duke ditur se Kosova vuan nga shkalla e lartë e varfërisë dhe papunësisë, përjashtim të grave nga aktivitetet socioekonomike, ne i drejtuam resurset tona kah zhvillimit socioekonomik të Kosovës. Momentalisht IKC-ja po zbaton dy projekte, një të financuar nga Kooperativa Suedeze We EFFECT, kurse tjetri i financuar nga Ambasada Britanike. Të dy projektet kanë për qëllim zhvillimin e shoqërisë rurale të Kosovës nëpër-

mjet organizimit dhe zhvillimit të biznesit. Për faktin se IKC-ja i përfshin të gjitha grupet etnike, gjinitë dhe sidomos bashkësitë e marginalizuara, IKC-ja punon në 10 komuna ku për nevojat për punësim janë më tepër se kryesore: Ferizaj, Shtime, Lipjan, Viti, Klokot, Stërpçe, Partesh, Han i Elezit, Kaçanik dhe Gjakova. Deri më tani IKC-ja ka organizuar mbi 700 bujq në organizata të grave (WOs) dhe në organizata bujqësore (FOS). Midis tyre, më tepër se 50% janë WOs, kështu që gratë përforcohen ekonomikisht, politikisht dhe në anën sociale.

FONDACIONI AGRINET SHQIPËRIA



AgriNET është organizatë shqiptare apolitike, joqeveritare dhe jofitimprurëse e regjistruar në shkurt të vitit 2005 me seli në rajonin e Korçës. Tani ajo është rrjetë e 15 organizatave bujqësore nga tre rajone të Shqipërisë. Qëllimi i kësaj organizate është pjesëmarrja aktive dhe e drejtpërdrejtë në proceset sociale, ekonomike dhe ekologjike të zhvillimit të qëndrueshëm të bashkësive të cilat jetojnë në rajone rurale në partneritet me sektorët ruralë të marginalizuar, bashkësitë e tyre dhe palët e ndryshme të prekura. AgriNet e realizon misionin e vet nëpërmjet implementimeve të ndryshme në projektin në fushën e zhvillimit rural financuar nga institucionet vendase dhe ndërkombëtare, si edhe nëpërmjet përfshirjes së drejtpërdrejtë të bashkësive, pushtetit lokal dhe organizatave të tjera joqeveritare në fushën e zhvillimit rural të bashkësisë.

AgriNet siguron shërbime të zgjeruara në pjesën më të madhe të rasteve për grupe formale dhe joformale të prodhuesve bujqësorë.

Lloji kryesor i grupeve bujqësore për shërbime të zgjeruara janë: grupet e prodhuesve të cilët zbatojnë Praktika bujqësore të mira (Good Agricultural Practices - GAP), zbatim i trajnimeve të moderuara nga ekspertë në nivel nacional, organizim i shkëmbimit të përvojave për prodhuesit bujqësorë inovativë, organizim i parcelave demonstruese për testim dhe zbatim të teknologjive inovuese dhe zhvillim të publikimeve të cilat kanë të bëjnë me zbatimin e teknologjive inovuese dhe GAP.